

BARAZIA GJINORE DHE FUQIZIMI I GRAVE NGA ZONAT RURALE, PËRMES PËRFSHIRJES NË TREGUN E PUNËS

RAPORT AUDITIMI PERFORMANCE





BARAZIA GJINORE DHE FUQIZIMI I GRAVE NGA ZONAT RURALE, PËRMES PËRFSHIRJES NË TREGUN E PUNËS

Raport Auditimi Performance

Tiranë 2024

Lista e shkurtesave

VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave
NJQV	Njësi të Qeverisjes Vendore
KB	Këshilli Bashkiak
VKB	Vendim i Këshillit Bashkiak
ISSAI	Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit
INTOSAI	Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit
EUROSAI	Organizata Evropiane e Institucioneve Supreme të Auditimit
SKBGJ	Strategjia Kombëtare për Barazinë Gjinore
AKPA	Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive
PKV	Plani Kombëtar i Veprimit
PATP	Programe Aktive të Tregut të Punës
SKPA	Strategjia Kombëtare për Punësim dhe Aftësi
PNP	Programet e Nxitjes së Punësimit
Pu.Pa	Punëkërkuar të Papunë

Përmbajtja

1. PËRMBLEDHJE	8
2. PROBLEMI SOCIAL DHE RËNDËSIA E AUDITIMIT	11
2.1 Konteksti i Problemit Social	11
2.2 Rëndësia e auditimit të performancës	12
3. SUBJEKTET NËN AUDITIM	13
3.1 Hyrje në subjektet nën auditim	13
3.2 Baza ligjore dhe kriteret e tjera që rregullojnë çështjen nën auditim	17
3.3 Rëndësia e produkteve të subjektit	18
3.4 Pesha në buxhe	19
3.5 Feedback-u i subjekteve	20
4. DETAJET E AUDITIMI	21
4.1 Vlerësimi i risqeve të aktiviteteve të subjekteve	21
4.2 Objektivat e auditimi	22
4.3 Pyetjet e auditimit	23
5. SHTJELLIMI I PYETJEVE TË AUDITIMIT	24
A mundësojnë programet kombëtare punësimin aktiv të grave në zonat rurale?	24
5.2 A janë marrë masa konkrete që nxisin përfshirjen e grave rurale në tregun e punës?	46
5.3A ka ndërveprim të institucioneve qendrore me strukturat vendore për nxitjen e punësimin të grave rurale?	59
6. ANEKS	68

Nga vitit 1995, për të vlerësuar kontributin e grave rurale në bujqësi dhe arritjet e tyre në mirëqenien e përgjithshme të komunitetit, pavarësisht nga sfidat dhe stereotipet me të cilat përballen, shënohet "*Dita Ndërkombëtare e Grave Rurale*".

Kontrolli i Lartë i Shtetit në përmbushje të Strategjisë 2023-2027, në të cilën shprehet se: "*Suksesi do të qëndrojë në masën në të cilën KLSH-ja, do të mund të ushtrojë ndikim në sistemin e përgjegjshmërisë dhe llogaridhënies, në ndihmë të forcimit të institucioneve të qëndrueshme*", zhvilloi auditimin e performancës me temë "*Barazia gjinore dhe fuqizimi i grave nga zonat rurale, përmes përfshirjes në tregun e punës*". Ky auditim u zhvillua edhe në vijimësi të punës për auditimin e zbatimit të Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm të Kombeve të Bashkuara, si një thirrje globale për veprim për t'i dhënë fund varfërisë, për të mbrojtur mjedisin dhe klimën në Tokë dhe, për të siguruar që njerëzit, pavarësisht vendndodhjes, të mund të gëzojnë paqe dhe mirëqenie.

Auditimi u realizua në bashkëpunim me Zyrën Kombëtare të Auditimit të Kosovës, Entin Shtetëror të Revizionit të Maqedonisë së Veriut dhe UN Women Shqipëri, si dhe në kuadër të përcaktimeve të Objektivit të Zhvillimit të Qëndrueshëm nr. 5 / Barazi gjinore / "Arritja e barazisë gjinore dhe fuqizimi i të gjitha grave dhe vajzave". **

Kontrolli i Lartë i Shtetit

** <https://albania.un.org/sq/sdgs/5>

1

PËRMBLEDHJE

Auditimi me temë “Barazia gjinore dhe fuqizimi i grave nga zonat rurale, përmes përfshirjes në tregun e punës”, është konceptuar të vlerësojë politikat dhe efektivitetin e tyre në funksion të përmbushjes cilësore të shërbimeve të ofruara për nxitjen e punësimit të grave në zonat rurale, duke u fokusuar kryesisht në rolin dhe përgjegjësitë që subjektet nën auditim AKPA dhe 13 Njësi të Qeverisjes Vendore (NJQV): Shkodër, Kukës, Lezhë, Dibër, Krujë, Elbasan, Kavajë, Divjakë, Lushnjë, Berat, Pogradec, Vlorë dhe Gjirokastrë, kanë pasur për periudhën objekt auditimi (vitet 2019-2023), lidhur me nxitjen e punësimit të grave nga zonat rurale në territorin e tyre. Referuar objektivave të auditimit dhe konceptimit të piramidës së pyetjeve, në mënyrë të përmbledhur, nga auditimi rezultuan problematikat e paraqitura më poshtë:

Strategjia Kombëtare për Barazinë Gjinore 2021-2030, për fuqizimin ekonomik të grave, synon fuqizimin socio-ekonomik të grave, përfshirë edhe grupin e “grave rurale”. Nga ana tjetër, Strategjia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive 2023-2030 (aktualisht në fazën e draftit për konsultim publik), planifikon si qëllim strategjik, mundësimin e punësimit të denjë për gra dhe burra, nëpërmjet zbatimit të politikave gjithëpërfshirëse të tregut të punës. Strategjia e Punësimit, nuk paraqet klasifikime të tjera brenda grupit të grave, ndryshe nga strategjia për barazi gjinore, e cila identifikon dhe përfshin si grup “gratë nga zonat rurale”. Në hartimin e objektivave të SKPA-së 2023-2030, nuk është zbatuar parimi i përgjithshëm që strategjitë kombëtare, duhet të jenë në harmoni me kornizën e SKZHIE 2030, ku përfshihet edhe SKBGJ 2021-2030.

Ky auditim është orientuar në disa drejtime kryesore, të cilat janë:

Vlerësimi i programeve të nxitjes së punësimit, nëse këto programe kanë qenë të diversifikuara dhe të përshtatura për rajone të veçanta, mbi baza gjinore, si dhe nëse janë zbatuar në të gjithë vendin, në mënyrë eficiente dhe efektive, duke siguruar barazi gjinore;

Vlerësimi i ofrimit të kushteve që lehtësojnë punësimin e grave nga zonat rurale, sikurse është investimi në shërbime publike, çerdhe dhe kopshte për fëmijët apo transport nga zonat rurale për në qendrat e punës;

Bashkëpunimi dhe koordinimi midis NJQV-ve dhe AKPA-s në punësimin e grave;

Monitorimi i zbatimit të politikave të punësimit dhe arritja e qëllimeve përmes analizimit të proceseve.

Në zbatim të Strategjisë Kombëtare për Punësim dhe Aftësi 2019–2022, u miratua Ligji i ri Nr. 15/2019, datë 13.03.2019 “Për Nxitjen e Punësimin”, i cili hapi rrugën për ristrukturimin e Shërbimit Kombëtar të Punësimin në Agjencinë Kombëtare të Punësimin dhe Aftësive, rikonceptimin e marrëdhënieve me punëdhënësit, krijimin e një sistemi informacioni të tregut të punës dhe të tjerë. Bazuar në këtë ligj, politikat publike të punësimin përfshijnë shërbimet e punësimin dhe programet aktive e pasive të tregut të punës, të cilat synojnë nxitjen e punësimin të punëkërkuësve të papunë, integrimin dhe përfshirjen sociale të grupeve të veçanta. Agjencia Kombëtare e Punësimin dhe Aftësive, në cilësinë e institucionit përgjegjës për zbatimin e politikave aktive të nxitjes së punësimin për mbështetjen e punëkërkuësve të papunë, me programet aktive të Nxitjes së Punësimin, ka zbatuar katër VKM-të e miratuara në zbatim të ligjit, për programet e reja të nxitjes së punësimin, që përfshijnë angazhimin e punëkërkuësve të papunë në programe të ndryshme punësimi.

Programet e nxitjes së punësimin, janë konceptuar në formë të tillë, që të adresojnë dhe nevojat e kategorive të disavantazhuara të punëkërkuësve të papunë. Sa më sipër, rezultoi se AKPA nuk ka qenë plotësisht efektive në aktivitetin e saj për punësimin e grave në zonat rurale. Nga auditimi rezultoi se, programet e nxitjes së punësimin të realizuara nga AKPA gjatë viteve 2020–2023, janë të përgjithshme dhe jo të ndara në bazë gjinore, aq më pak me fokus të qartë për gratë në zonat rurale. Të dhënat lidhur me programet e nxitjes së punësimin, nuk flasin për gratë rurale. Mungojnë treguesit e matshëm sasiorë ose cilësorë gjinorë në realizimin e programeve dhe kartën e performancës, të nevojshëm për të monitoruar ecurinë e rezultateve të arritura dhe përmbushjen e qëllimeve specifike, duke ndikuar në efektivitetin e zbatimit të këtyre programeve për fuqizimin e grave në zonat rurale.

Nga strukturat e AKPA-s, është realizuar gjurmimi vetëm për programet e përfituara nga punëkërkuësit në vitin 2020, ndërkohë që, referuar përcaktimeve të rregulloreve të zbatimit të programeve, ky proces duhej të realizohej 6 muaj mbas përfundimit të këtyre programeve. Gjithashtu, ka munguar një koordinim efektiv ndërmjet DRAKPA-ve dhe NJQV-ve për sa i përket hartimit dhe analizimit të nevojave të punësimin të grave në zonat rurale.

Një nga nënobjektivat e Strategjisë Kombëtare për Barazinë Gjinore 2016–2020, tregues për fuqizimin e grave në zonat rurale, është dhe nënobjektivi “1.3.14. Ofrimi i çerdheve dhe kopshteve në zonat rurale”, i cili ka si institucione zbatuese njësitë e qeverisjes vendore. Grupi i auditimit vlerësoi masat e marra nga Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore, objekt auditimi në drejtim të zvogëlimit të barrierave, që i mbajnë gratë, të rejat dhe vajzat, larg tregut të punës. Nga analizimi i të dhënave të grumbulluara nga Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore, konstatohet se, pothuajse në të gjitha bashkitë, raporti i çerdheve dhe kopshteve, nuk është në proporcion të drejtë me njësitë administrative rurale dhe ato urbane, sipas secilës Bashki. Referuar të dhënave të raportuara, mungojnë çerdhet, kryesisht në zonat rurale dhe në disa raste edhe në zonat urbane. Për rrjedhojë, nuk sigurohet një mbulim i plotë dhe ndarje e drejtë sipas zonave urbane dhe rurale, me kopshte dhe çerdhe sipas nevojave që kanë këto njësi të vetëqeverisjes vendore.

Një tjetër mangësi e konstatuar, është fakti se, në disa njësi të qeverisjes vendore, nuk sigurohet transport publik përveçse në njësitë administrative urbane. Për rrjedhojë, nuk sigurohen kushte lehtësimi, për të afruar gratë dhe vajzat sa më afër tregut të punës, duke penguar forcimin e pozitës së gruas në shoqëri.

Agjencia Kombëtare e Punësimin dhe Aftësive, në kuadër të forcimit dhe të bashkërendimit të politikave të punësimin në nivel rajonal dhe vendor, ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore. Përkatesisht, që nga miratimi i SKPA-së në vitin 2019 e deri në vitin 2021, janë nënshkruar 16 akt-marrëveshje me bashki të ndryshme (Elbasan, Gramsh, Librazhd, Peqin, Cërrik, Përrenjas, Fier, Lushnjë, Patos, Roskovec, Korçë, Maliq, Lezhë, Laç, Mirditë dhe Delvinë). U auditua zbatimi i 3 akt-marrëveshjeve të lidhura me bashkitë që janë objekt i auditimit, si bashkitë: Lushnjë, Lezhë dhe Elbasan. Nga auditimi rezultoi se, detyrimet e përcaktuara në akt-marrëveshjet

e nënshkruara, nuk janë zbatuar. Aktivitetet e zhvilluara në kuadër të nxitjes së punësimit, nuk dokumentohen. Njësisë Administrative që janë në distancë të largët nga Zyrat Vendore të Punës, nuk regjistrojnë punëkërkesit në një regjistër, i cili më pas të dërgohet periodikisht pranë Zyrës Vendore të Punës. Gjithashtu, në Njësitë Administrative, nuk është caktuar një person për të koordinuar punën dhe për të adresuar çështjet e punësimit në Zyrën Vendore të Punës.

AKPA, nga ana e saj, nuk ka dokumentuar ecurinë e zbatimit të marrëveshjeve të nënshkruara me bashkitë: Elbasan, Lushnjë dhe Lezhë. Gjithashtu, nuk është kryer një vlerësim mbi efektivitetin e tyre në përmirësimin e situatës së punësimit.

Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive, nuk ka ngritur pika shërbimi në Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore, të cilat nuk kanë zyra vendore punësimi, sikundër është përcaktuar në Strategjinë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive.

Mangësi, u evidentuan edhe në shërbimet e punësimit të ofruara nga Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive, të cilat nuk janë plotësisht të bashkërenduara me njësitë e vetëqeverisjes vendore. Komunikimi midis strukturave qendrore dhe vendore, nuk identifikon nevojat e grave në përgjithësi dhe grave rurale në veçanti. Aktualisht edhe pse ka një bashkëpunim midis Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive dhe bashkive, nuk mund të themi që ofrohen shërbimeve efektive për punëkërkesit, në rastin tonë: gratë rurale. Shkëmbimi i informacionit me njësitë e vetëqeverisjes vendore, nuk sjell adresimin e problemeve që i mbajnë gratë rurale larg tregut të punës.

Edhe pse AKPA e ka monitoruar periodikisht zbatimin e aktiviteteve të përcaktuara për t'u realizuar me qëllim arritjen e objektivave të Strategjisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive 2019-2022, nuk konstatohet se si janë përdorur konkretisht rezultatet e monitorimit për të përmirësuar politikat e punësimit, apo cilat janë përmirësimet specifike që janë bërë përkatësisht, në referencë të rezultateve të monitorimit.

Monitorimi i zbatimit të Strategjisë Kombëtare për Punësim dhe Aftësi 2019-2022, është kryer periodikisht për çdo aktivitet, si dhe janë hartuar raportet e monitorimit. Parë në fokusin e auditimit, konstatohet se të dhënat, grupohen në gra dhe burra dhe nuk ka klasifikim grupi "gratë rurale". Për asnjë aktivitet të strategjisë, nuk ka të dhëna që lidhen me gratë rurale. Gjithashtu, nuk konstatohet që, monitorimi i kryerjes së aktiviteteve për zbatimin e objektivave të punësimit, të ketë shërbyer edhe për të identifikuar problematika apo për të adresuar çështje për përmirësim. Nuk mund të kuptohet qartë nëse janë hartuar politika për nxitjen e punësimit në referencë të rezultateve të monitorimit dhe nëse po, çfarë politikash.



Në përfundim, konstatojmë se nevojitet që analizat e tregut të punës për gratë në zonat rurale, të bëhen me të dhëna të disagreguara e të mbledhura në mënyrë të përditësuar, si dhe me gjetje e rekomandime, të cilat të ndahen edhe me grupet e interesit dhe mund të vihen në zbatim në funksion të secilës bashki apo njësi administrative, sipas specifikave dhe veçorive përkatëse.

Është shumë e rëndësishme që, mundësi të barabarta, u duhen ofruar të gjitha të rejave dhe grave nga të gjitha grupet në shoqëri, duke përfshirë ato që jetojnë në zona rurale apo dhe më larg, etj...

2

PROBLEMI SOCIAL DHE RËNDËSIA E AUDITIMIT

2.1 Konteksti i Problemit Social

Që nga viti 1995, për të vlerësuar kontributin e grave rurale në bujqësi dhe arritjet e tyre në mirëqenien e përgjithshme të komunitetit, pavarësisht nga sfidat dhe stereotipet me të cilat përballen, shënohet '*Dita Ndërkombëtare e Grave Rurale*'.

Zonat rurale të Shqipërisë, e kanë përqendruar aktivitetin ekonomik, kryesisht në sektorin e bujqësisë dhe blegtorisë. Në disa nga bashkitë e vogla në zonat veriore, të tilla si: Hasi, Tropoja, Kukësi, Puka, Vau i Dejës apo Malësia e Madhe, pjesa më e madhe e të punësuarve dhe vetëpunësuarve, janë gratë dhe vajzat.

Janë të shumta sfidat dhe kushtet me të cilat punojnë gratë në zonat rurale. Ato përballen çdo ditë jo vetëm me punët e shtëpisë, por edhe me vështirësitë e punës në bujqësi. Situata e krijuar për shkak të sfidave që po kalon bota, ka shtrirë ndikimin e vet edhe në sektorin e bujqësisë me rritjen e çmimit të naftës dhe inputeve bujqësore, por edhe me vështirësitë e krijuara për shitjen e prodhimeve bujqësore, të cilat rëndojnë në jetën e grave të zonave rurale. Strategjitë kombëtare por edhe projektet e shoqatave të ndryshme, diktojnë nevojën për identifikimin e problematikave të grave dhe vajzave, në pjesën më të madhe të bashkive në vend. Drejtueset e qendrave apo shoqatave të ndryshme për fuqizimin e grave në zonat rurale, shprehen se në bazë të studimeve të tyre, megjithëse rreth 96% e punëve në bujqësi kryhen nga gratë, të ardhurat e përfituara nuk administrohen prej tyre.



NË SHQIPËRI

Gratë përbëjnë rreth **55% të forcave të punës** në sektorin e blegtorisë.

Ato drejtojnë vetëm **7% të fermave** bujqësore dhe blegtorale të vendit.

Gratë dhe vajzat, krahas punëve të tjera të përditshme, punojnë shumë në bujqësi dhe blegtori. Megjithëse në Shqipëri gratë luajnë një rol të rëndësishëm në sektorin e bujqësisë, pasi përbëjnë rreth 55% të forcave të punës, ato drejtojnë vetëm 7% të fermave bujqësore dhe blegtorale të vendit¹. Në procedurat e ndjekura për t'u përfshirë në tregun e punës, ato shpesh hasin problematika, si për shembull: në bërjen e aplikimeve, në hapjen e një biznesi, apo në drejtimin e një biznesi në këto prona, etj.

Faktorë të tjerë që kanë ndikim të drejtpërdrejtë në punësimin e grave nga zonat rurale, janë edhe problematika që dalin nga infrastruktura, zona ku jetojnë, mungesa e transportit, ujit të pijshëm, mungesa e qendrave shëndetësore 24 orë, si dhe e çerdheve dhe kopshteve me drekë. Këta faktorë, edhe pse janë shqetësim i të gjithë komunitetit, së pari, rëndojnë mbi jetën e grave dhe vajzave të zonave rurale. Sa trajtuar më sipër, janë strukturat qendrore dhe sidomos njësitë e vetëqeverisjes vendore që duhet të marrin masa për të ulur faktorët pengues dhe me qëllim nxitjen e grave nga zonat rurale për t'u përfshirë në tregun e punës.

2.2 Rëndësia e auditimit të performancës

Auditimi në vetvete, është një instrument thelbësor i procesit të llogaridhënies për shpenzimin e parave publike, duke dhënë kështu një kontribut të rëndësishëm për miradministrimin e burimeve dhe kryerjen e shërbimeve për qytetarët. Ndërsa nëpërmjet auditimit të performancës, bëhet një shqyrtim i pavarur për të kuptuar nëse angazhimet qeveritare, operacionet, programet, dhe aktivitetet, janë në përputhje me parimet e ekonomicitetit, efijencës dhe efektivitetit dhe nëse ka vend për përmirësim. Kontrolli i Lartë i Shtetit auditon midis të tjerave, veprimtarinë ekonomiko-financiare të institucioneve shtetërore e të personave të tjerë juridikë publikë, duke rekomanduar masat e duhura për përmirësimin e performancës. KLSH-ja nëpërmjet auditimit, bën transparent përdorimin e fondeve publike, administrimin e pronës publike dhe ligjshmërinë e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, procedurat, legalizimet, kryerjen në kohë e me cilësi dhe kosto optimale të shërbimeve publike, etj.²

Ky auditim, ka në fokus kryesisht fuqizimin e grave nga zonat rurale, përmes përfshirjes së tyre në tregun e punës, si dhe efektivitetin e procedurave dhe mekanizmave kryesorë, që identifikojnë dhe zhvillojnë infrastrukturën e nevojshme për realizimin e objektivave strategjike për respektimin e të drejtave të tyre, si dhe ndërgjegjësimin e familjeve dhe komunitetit për fuqizimin e tyre. Bazuar sa më lart, ky lloj auditimi ka si synim të rekomandojë përmirësime për zbatimin e politikave dhe programeve qeveritare, dhe rritjen e përfshirjes së grave rurale në tregun e punës.

1. <https://www.instat.gov.al/media/12598/burra-dhe-gra-2023.pdf>.


2. Neni 6 i Ligjit Nr. 154/2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit".

3

SUBJEKTET NËN AUDITIM

3.1 Hyrje në subjektet nën auditim

Auditimi i Performancës me temë *“Barazia gjinore dhe fuqizimi i grave nga zonat rurale, përmes përfshirjes në tregun e punës”*, do të shtrihet në 13 bashki të vendit si dhe në Agjencinë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive. Grupi i auditimit ka përzgjedhur 13 Njësi të Qeverisjes Vendore (NJQV) për të vlerësuar angazhimin e institucioneve në nivel vendor, lidhur me nxitjen e punësimit të grave në zonat rurale në territorin e tyre. Përkatësisht, subjektet nën auditim janë:



Njësitë e Qeverisjes Vendore (Shkodër, Kukës, Lezhë, Dibër, Krujë, Elbasan, Kavajë, Divjakë, Lushnjë, Berat, Pogradec, Vlorë, Gjirokastër), sigurojnë qeverisjen e efektshme, efikase dhe në një nivel sa më afër qytetarëve nëpërmjet³:

- njohjes së ekzistencës së identiteteve dhe vlerave të ndryshme të bashkësive;
- respektimit të të drejtave dhe lirive themelore të shtetasve, të sanksionuara në Kushtetutë ose në ligje të tjera;
- zgjedhjes së llojeve të ndryshme të shërbimeve dhe lehtësive të tjera publike vendore në dobi të bashkësisë;
- ushtrimit efektiv të funksioneve, kompetencave dhe realizimit të detyrave nga organet e vetëqeverisjes vendore;
- realizimit të shërbimeve në forma të përshtatshme, bazuar në nevojat e anëtarëve të bashkësisë; dhe nxitjes efektive të pjesëmarrjes gjithëpërfshirëse të bashkësisë në qeverisjen vendore;
- realizimit të shërbimeve, në përputhje me standardet e kërkuara me ligj ose akte të tjera normative.
- NJQV-të kanë të drejta dhe përgjegjësi në krijimin e të ardhurave dhe kryerjen e shpenzimeve, pasi⁴:
- krijojnë, mbledhin të ardhura dhe bëjnë shpenzime për përmbushjen e funksioneve të tyre; b) vendosin taksa vendore e tarifa për shërbimet, si dhe nivelin e tyre, në përputhje me legjislacionin në fuqi;
- hartojnë, miratojnë dhe zbatojnë buxhetin e tyre;
- mbajnë llogaritë, në përputhje me legjislacionin në fuqi, dhe ofrojnë informacione ose raporte financiare për hartimin dhe zbatimin e buxhetit për qeverisjen qendrore ose shtetasit. Të ardhurat që përfitohen nga veprimtaria ekonomike, përdoren në pjesën më të madhe për mbështetjen dhe përmbushjen e funksioneve publike.

Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive (AKPA)

AKPA përfshin një tërësi institucionesh administrative rajonale dhe vendore që ofrojnë shërbime të punësimit, të vetëpunësimit dhe zhvillimit, arsimit e formimit profesional.

Misioni i AKPA-s, është të sigurojë përmbushjen e të drejtës së shtetasve, për t'u trajtuar me shërbime dhe programe publike të punësimit, të vetëpunësimit dhe të kualifikimeve profesionale, me qëllim gjetjen e një pune të përshtatshme, brenda dhe jashtë vendit, si dhe ofrimin e këtyre shërbimeve.

AKPA është e organizuar në nivel qendror dhe rajonal/vendor dhe ushtron kompetencat e mëposhtme⁵:

- administron strukturat rajonale/vendore të punësimit dhe garanton nivelin e cilësisë së shërbimeve të ofruara;
- në bashkëpunim me punëdhënësit, administron dhe zbaton programet e nxitjes së punësimit;
- administron ofruesit publikë të arsimit dhe formimit profesional (AFP), sipas legjislacionit në fuqi për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë;
- zbaton programet e formimit profesional;
- i propozon ministrisë përgjegjëse për çështjet e punësimit dhe zhvillimit të aftësive, aktet ligjore dhe nënligjore në fushën e nxitjes së punësimit;

Gjithashtu, AKPA, ka përgjegjësi që të garantojë nivelin e cilësisë së shërbimeve të ofruara për punësimin, vetëpunësimin dhe arsimin e formimin profesional, nëpërmjet monitorimit dhe vlerësimit. Për të përmbushur detyrimet që i lindin në zbatim të kuadrit ligjor në fuqi⁶, AKPA mbledh, përpunon dhe analizon informacion nëpërmjet sistemit të informacionit të institucioneve të varësisë ose nëpërmjet studimeve specifike apo anketimeve, që kanë të bëjnë me dinamikat dhe tendencat e tregut të punës apo të segmenteve të tij.

3. Ligji nr. 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore" i ndryshuar, neni 3.

4. Ligji nr. 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore" i ndryshuar, neni 9, pika 1.3 dhe 1.4.

5. Ligji nr. 15/2019 datë 13.03.2019 "Për nxitjen e punësimit", neni 14.

6. Ligji nr. 15/2019 datë 13.03.2019 "Për nxitjen e punësimit", neni 16.

Për sigurimin e këtij informacioni, AKPA ka si detyrim:

- mbledhjen, përpunimin dhe raportimin e informacionit për punëkërkesit e papunë, si dhe për vendet e lira të punës të shpallura në strukturën rajonale/vendore;
- kryerjen e studimeve periodike mbi tregun e punës apo të një pjese të tij, në nivel rajonal dhe kombëtar;
- kryerjen e monitorimit dhe vlerësimit të efikasitetit të programeve aktive të tregut të punës, si dhe ndjekjen në vazhdimësi të tyre.

Gjithashtu, AKPA kryen hulumtime periodike në tregun e punës për mbledhjen e të dhënave për numrin e të punësuarve, për kushtet e punës, procesin e rekrutimit, mungesën e aftësive apo të nevojave për trajnim, sipas metodologjive kombëtare dhe ndërkombëtare, të testuara e të miratuara.

Strategjia Kombëtare për Punësim dhe Aftësi 2019-2022

Shqipëria ka një strategji kombëtare për punësimin, e cila mbulon periudhën 2019-2022.

Strategjia Kombëtare për Punësim dhe Aftësi 2019-2022, është e përqendruar në katër përparësi për të nxitur vende pune dhe mundësi dhe aftësi për të gjithë, femra dhe meshkuj, gjatë gjithë ciklit të jetës.

Objektivat strategjikë janë:

- Nxitja e mundësive për punë të denjë, nëpërmjet politikave të frytshme të tregut të punës;
- Ofrimi i arsimit dhe formimit profesional cilësor për të rinjtë dhe të rriturit;
- Nxitja e përfshirjes sociale dhe kohezionit territorial;
- Fuqizimi i qeverisjes së tregut të punës dhe i sistemeve të kualifikimeve.

Objektivi kryesor i Strategjisë Kombëtare për Punësim dhe Aftësi, është identifikimi dhe skicimi i politikave të duhura nxitëse të punësimin në vend dhe formimit profesional të forcës së punës, me qëllim që të hapen vende pune cilësore dhe mundësi për aftësi gjatë gjithë ciklit të jetës.

Duke u fokusuar në temën tonë të auditimit, kemi identifikuar nënobjektivat apo qëllimet që lidhen direkt apo indirekt me mbështetjen e punësimin në zonat rurale.

A. Nxitja e mundësive për punë të denjë, nëpërmjet politikave të frytshme të tregut të punës.

- *Zgjerimi i gamës dhe shtrirjes së shërbimeve dhe Programeve Aktive të Tregut të Punës (PATP)*

Programet aktive të tregut të punës do të riprojektohen dhe riprojektimi do të fillojë me:

• Hartimin dhe diversifikimin e PATP-ve në bazë të nevojave të grupeve me rrezik të lartë për t'u bërë të papunë afatgjatë, i cili do të realizohet nëpërmjet:

- Vlerësimit të nevojave të grupeve të veçanta për mbështetje me PATP të identifikuar;

- Kuadri ligjor dhe rregullator për zbatimin e PATP-ve, do të jetë i rishikuar në bazë të ligjit nr. 15/2019 "Për nxitjen e punësimin", për të mbështetur ofrimin e PATP-ve të përmirësuara, të diversifikuara dhe të përshtatura për rajone të veçanta, mbi baza gjinore dhe grupesh sociale;

• Përmirësimin e procesit të planifikimit dhe zbatimit të programeve të nxitjes, me qëllim përmirësimin e efikasitetit dhe të impaktit të tyre; i cili do të realizohet nëpërmjet:

- Programeve të nxitjes, që do të jenë të zbatuara në të gjithë vendin, në mënyrë efektive dhe efektive, si edhe duke siguruar barazi gjinore, përfshirë kontraktimin;

- Duke siguruar statistikat e rregullta dhe të disponueshme mbi numrin e qytetarëve shqiptarë (femra dhe meshkuj), të mbështetur me punësim.

- *Zhvillimi dhe zbatimi i modelit për monitorimin e programeve aktive të tregut të punës (PATP) me ndjeshmëri për çështjet gjinore, i cili do të realizohet sipas masave të mëposhtme:*

Përcaktimi dhe miratimi i modelit për monitorimin e PATP-ve, ku:

- Kuadri metodologjik i vlerësimit dhe monitorimit, të jetë i hartuar për PATP-të;
- Instrumentet të jenë të përmirësuara për monitorimin e përfshirjes së grupeve të veçanta në PATP.

Zbatimi i planit të monitorimit të PATP-ve, ku:

- Struktura e monitorimit të programeve aktive të tregut të punës, të jetë e ngritur;
- Programet aktive të tregut të punës, do të jenë të monitoruara periodikisht në bazë të indikatorëve të standardizuar.

B. Ofrimi i Arsimit dhe Formimit Profesional (AFP) cilësor për të rinjtë dhe të rriturit.

- *Optimizimi i ofruesve të AFP-së në nivel individual dhe rrjeti për të siguruar një ofertë cilësore dhe më të larmishme, e cila do të arrihet nëpërmjet:*

Diversifikimit të ofertës në AFP, në përputhje me nevojat e tregut të punës;

- Oferta e AFP-së do të jetë e diversifikuar në përputhje me nevojat e tregut, trendet e migracionit dhe ato demografike, si dhe në bazë të parimeve të shumëfunktionalitetit, barazisë, diversitetit dhe fleksibilitetit;
- Do të sigurohet ofertë e përditësuar, sipas nevojave të tregut të punës;

Riorganizimi i rrjetit të ofruesve, duke marrë në konsideratë përputhjen e ofertës me kërkesën rajonale, nëpërmjet masave të mëposhtme:

- Do të hartohet harta e gjeografike për operacionalizimin e riorganizimit të rrjetit të ofruesve të AFP-së.

Përmirësimi i sistemit të menaxhimit të informacionit të AFP-së, nëpërmjet:

- Përcaktimit të modelit/sistemit të menaxhimit të informacionit të AFP-së në një sistem të unifikuar të menaxhimit të këtij informacioni.

C. Nxitja e përfshirjes sociale dhe kohezionit territorial.

- *Zgjerimi i mbulimit, përfshirjes dhe efektivitetit të shërbimeve të punësimit dhe arsimit dhe formimit profesional për të rinjtë dhe të rriturit, përfshirë edhe popullsinë e rrezikuar për përjashtim.*

Vlerësimi i nevojave për shërbime të punësimit dhe të formimit në zonat e pambuluara;

- Do të hartohet Raporti i vlerësimit të nevojave për shërbime punësimi dhe të AFP-së, në zonat
- e pambuluara të identifikuar me rekomandimet përkatëse;
- Do të bëhet regjistrimi i punëkërkuessve të papunë, si femra ashtu edhe meshkuj, nga zonat e pambuluara.

Hartimi i planit të shtrirjes territoriale të shërbimeve të punësimit dhe arsimit dhe formimit profesional;

- Plani i detajuar për ofrimin e shërbimeve të punësimit dhe të AFP-së, në zonat e pambuluara;
- Ofrimi i shërbimeve të punësimit dhe pjesëmarrja e garantuar në programet e AFP-së për individët që jetojnë në zonat e pambuluara.

Zbatimi i planit të shërbimeve në zonat e pambuluara;

- Modalitetet dhe marrëveshjet e bashkëpunimit me njësitë vendore, duke përcaktuar rolet reciproke dhe llojin e shërbimeve që do të ofrohen në zonat e pambuluara me zyra punësimi dhe formimi;
- Do të ngrihen pika shërbimi pranë njësive të qeverisjes vendore;

Zbatimi i planit për AFP-në në zonat e pambuluara;

- Nevojat për kualifikime profesionale janë të identifikuar;
- Ridizenjimi i paketave të aftësive dhe kualifikimeve të përshtatura për ekonomitë rurale bazuar në vlerësimin e analizës së hendeikut të aftësive;
- Shërbime të ofruara në zonat e pambuluara;
- Kurset e formimit profesional të ofruara për punëkërkuessit e papunë, si femra ashtu edhe meshkuj, në zonat e pambuluara.

Nxitja e riintegritimit në tregun e punës

- Hartimi i skemës riintegruese në tregun e punës së përfituesve të skemës së Ndihmës Ekonomike;
- Shërbimet e punësimit të harmonizuara me Shërbimin Social Shtetëror, për të identifikuar e minimizuar faktorët shkurragues për hyrjen në tregun e punës dhe për të realizuar daljen nga skema e ndihmës ekonomike.

- Ngritja e mekanizmit monitorues, i cili gjurmon situatën e femrave dhe meshkujve vulnerabël dhe/ose të përjashtuar nga shoqëria në Shqipëri.

D. Fuqizimi i qeverisjes së tregut të punës dhe i sistemeve të kualifikimeve.

- Forcimi i sistemit të monitorimit dhe vlerësimit të politikëbërjes në sektorin e punësimit dhe të AFP-së;
- Zhvillimi dhe përmirësimi i sistemit të informacionit të tregut të punës dhe AFP-së, që garanton të dhëna të sigurta dhe të përditësuara.

3.2 Baza ligjore dhe kriteret e tjera që rregullojnë çështjen nën auditim

Baza ligjore kryesore që rregullon aktivitetin e subjekteve lidhur me çështjen nën auditim, që do të jetë edhe burimi i kriterëve të auditimit, është si vijon:

Kriteret politike

- Strategjia Kombëtare për Punësim dhe Aftësi 2019-2022;
- Strategjia Ndërsektoriale për Decentralizimin dhe Qeverisjen Vendore 2015-2020"

Kriteret teknike

- Ligji nr. 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", i ndryshuar;
- Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor";
- Ligji nr. 15/2019, datë 13.03.2019 "Për nxitjen e punësimit";
- Ligji nr. 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore";
- VKM nr. 465, datë 18.07.2012 "Për integrimin gjinor në Programin Buxhetor Afatmesëm";
- VKM nr. 17, datë 15.01.2020 "Për procedurat, kriteret dhe rregullat për zbatimin e programeve të nxitjes së punësimit nëpërmjet punësimit, formimit në punë dhe praktikave profesionale";
- VKM nr. 348, datë 29.4.2020 "Për procedurat, kriteret dhe rregullat për zbatimin e programit të nxitjes nëpërmjet vetëpunësimit";
- VKM nr. 535, datë 08.07.2020 "Për procedurat, kriteret dhe rregullat për zbatimin e programit të punëve publike në komunitet";
- VKM nr. 608, datë 29.07.2020 "Për procedurat, kriteret dhe rregullat për zbatimin e programit të nxitjes nëpërmjet punësimit të personave të dalë të papunë si pasojë e COVID-19";
- VKM nr. 554, datë 31.07.2019 "Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive";
- Udhëzimi nr. 23, datë 30.07.2018 "Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm të njësive të vetëqeverisjes vendore";
- Udhëzimi nr. 22, datë 30.07.2022 "Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të njësive të vetëqeverisjes vendore";
- Udhëzim nr. 7/1, datë 28.2.2018 "Për përgatitjen e programit buxhetor Afatmesëm 2019-2021";
- Urdhri i Kryeministrit nr. 172, datë 24.12.2019 "Për miratimin e strukturës dhe organikës së Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive";
- Rregullore e brendshme për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive.

Kriteret e monitorimit dhe raportimit

- Urdhrat për monitorimin e implementimit të programeve;
- Raporte vjetore monitorimi.

Kriteret e tjera/Praktikat më të mira

- Raporte të ndryshme; Etj

3.3 Rëndësia e produkteve të subjektit

Subjektet e përfshira në këtë auditim janë, si në nivel qendror (AKPA), ashtu edhe në nivel vendor (NJQV dhe Zyrat Vendore të AKPA-s). Sikurse është përmendur më sipër, përgjegjësinë kryesore për zbatimin e politikave të punësimit në vend, e ka AKPA. Gjithashtu, AKPA kryen monitorimin dhe vlerësimin e efikasitetit të programeve aktive të tregut të punës, si dhe ndjekjen në vazhdimësi të tyre.

Nga të dhënat e analizuara rezulton se, 50% e punëkërkesve të papunë janë femra, dhe ky trend nuk ka pësuar ndryshime që nga viti 2019 e në vijim. Në mënyrë të përmbledhur, të dhënat paraqiten në tabelën në vijim:

Tabela nr. 1: Përmbledhëse e Pu.Pa, për periudhën 2019-2022

Viti	Pu.Pa Total	Pu.Pa Femra	%	Pu.Pa Kryefamiljare	%	Të punësuar në total
2019	70,930	37,228	52	29,417	79	30,391
2020	82,921	43,647	53	33,474	77	23,118
2021	87,419	45,125	52	33,340	74	24,158
2022	76,879	40,620	53	28,743	71	26,808

Burimi i të dhënave: AKPA, përpunoi grupi i auditimit.

Nga të dhënat statistikore të paraqitura nga AKPA, nuk evidentohet se sa % e Punëkërkesve të Papunë vijnë nga zonat urbane dhe sa % vijnë nga zonat rurale. Në qoftë se do të analizojmë numrin e femrave Pu.Pa Kryefamiljare kundrejt Pu.Pa femra, vihet re se, mesatarisht 75% e femrave Pu.Pa, janë Kryefamiljare. Në skemën e pagesës së papunësisë gjatë vitit 2022, kanë hyrë mesatarisht 418 përfitues çdo muaj dhe kanë dalë mesatarisht 468 përfitues çdo muaj. Në një raport të Avokatit të Popullit në vitin 2019⁷, rekomandohet që Ministria e Financave dhe Ekonomisë, të ofrojë kurse të formimit profesional në përputhje me kërkesat e tregut të punës për personat që janë pjesë e skemës së ndihmës ekonomike. Gjithashtu, edhe AKPA nga ana e saj, ka konstatuar nevojën për përmirësimin e protokolleve për fuqizimin e kategorisë Pu.Pa që trajtohen me ndihmë ekonomike para hyrjes në tregun e punës, si dhe bashkëpunimin me njësitë e qeverisjes vendore për zgjidhjen e çështjeve sociale⁸.



7. Raporti i monitorimit për shpërndarjen e ndihmës ekonomike dhe respektimin e të drejtave të kategorisë së personave me aftësi të kufizuara.

8. Analiza Vjetore e AKPA-s, viti 2019.

Programet e punësimit

Në vitin 2019 përpara miratimit të SKPA kanë qenë vetëm dy programe punësimi përkatësisht:

1. Mbi zbatimin e programeve të praktikave profesionale për punëkërkesit e papunë, që kanë mbaruar arsimin e lartë⁹;
2. Për pagesën e pjesëmarrjes në kurset e formimit profesional¹⁰.

Në kuadër të zbatimit të ligjit të ri "Për Nxitjen e Punësimit", në fund të vitit 2019 e në vijim, janë hartuar katër programe të nxitjes së punësimit, përkatësisht:

1. VKM nr. 17, datë 15.1.2020 "Për procedurat, kriteret dhe rregullat për zbatimin e programeve të nxitjes së punësimit nëpërmjet punësimit, formimit në punë dhe praktikave profesionale", e ndryshuar. Me miratimin e kësaj VKM-je, është shfuqizuar VKM nr. 873 e sipërcituar;
2. VKM nr. 348, datë 29.4.2020 "Për procedurat, kriteret dhe rregullat për zbatimin e programit të nxitjes nëpërmjet vetëpunësimit", e ndryshuar;
3. VKM nr. 608, datë 29.07. 2020 "Për procedurat, kriteret dhe rregullat për zbatimin programit të nxitjes së punësimit nëpërmjet punësimit të personave të dalë të papunë si pasojë e Covid-19" e ndryshuar;
4. VKM nr. 535, datë 08.07. 2020 "Për procedurat, kriteret dhe rregullat për zbatimin programit të punëve publike në komunitet".

Numri i pjesëmarrësve në PNP-të e reja gjatë vitit 2021, rezulton të jetë 4% më pak se realizimi i vitit të kaluar.



Si përfundim, hartimi i programeve të punësimit që vlerësojnë nevojat e punëkërkesve të papunë, zbatimi i tyre dhe monitorimi i rezultateve, nëse realizohen kanë një ndikim të drejtpërdrejtë në përfshirjen e grave nga zonat rurale në tregun e punës dhe si rezultat në përmirësimin e gjendjes ekonomike të familjeve të tyre.

3.4 Budget significance

Buxheti për mbështetjen e barazisë gjinore në vendin tonë, i parashikuar në Strategjinë Kombëtare për Barazinë Gjinore (SKBGJ) 2016-2020, është hartuar mbështetur në katër qëllime strategjike, si dhe në aktivitetet e pasqyruara në planin e veprimit, në kohështirjen dhe frekuencën e zbatimit të tij. Buxheti i planifikuar për zbatimin e strategjisë, është reflektuar në disa forma:

- Buxheti i përgjithshëm sipas viteve për secilin aktivitet, objektiv specifik, qëllim strategjik dhe burimeve të financimit;
- Buxheti i detajuar sipas aktiviteteve, burimeve të financimit dhe institucioneve përgjegjëse;
- Në klasifikimin e financimeve nga buxheti, janë përfshirë edhe fondet që Ministrinë, NJVQV, Partinë Politike, Kuvendi i Shqipërisë dhe Institucione të tjera buxhetore, të cilat duhet të planifikojnë shpenzime për zbatimin e kësaj strategjie. Pjesa më e madhe e shpenzimeve, nevojitet për mbulimin e pagave të koordinatorëve të MKR dhe Nëpunësve Gjinorë Vendor (më tej NGJV).
- Janë identifikuar fondet e angazhuara nga buxheti i shtetit dhe fondet që nevojiten për t'u siguruar nga donatorë dypalësh dhe shumëpalësh që, për financimin e një pjese të aktiviteteve, duhet të lidhen marrëveshje me donatorë potencialë.

9. VKM nr. 873, datë 27.12.2006 "Për masën e financimit, kriteret dhe procedurat e zbatimit të programeve të praktikave profesionale për punëkërkesit e papunë, që kanë mbaruar arsimin e lartë, brenda apo jashtë vendit".

10. VKM nr. 162, datë 21.03.2018 "Për pagesën e pjesëmarrjes në kurset e formimit profesional".

Shpenzimet e nevojshme për zbatimin e Planit Kombëtar të Veprimit (më tej PKV), kanë burime financimi nga buxheti i shtetit, buxheti i njërive të qeverisjes vendore, fondet e donatorëve dhe burime të institucioneve jobuxhetore, ku janë parashikuar rreth 2,785 milionë lekë. Risqet kryesore të cilat kanë pasur efekt në zbatimin me sukses të strategjisë, kanë lidhje me të dy nivelet e qeverisjes: Qeverinë Qendrore (Ministritë përgjegjëse për zbatimin e PKV) dhe Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore. Për NJQV, këto shpenzime mbulohen nga buxheti i NJVQV dhe Fondi për Zhvillimin, kryesisht në vitet 2019-2020, për të cilat deri tani, nuk ka raportime për zbatimin faktik të buxheteve përkatëse.

Tabela 2. Buxheti i Strategjisë për Barazi Gjinore dhe hendeku financiar në %¹¹

					000/Lekë
Përshkrimi	Kosto totale	Shpenzime të financuara	Shpenzime të pambuluara	Shpenzime të financuara në %	Hendeku financiar në %
Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore	1,666,939.30	1,310,944	355,995	78.60%	21.40%

Sa i përket njërive të vetëqeverisjes vendore objekt i këtij auditimi, në projektbuxhetet e tyre, nuk ka një planifikim me zë të veçantë për fuqizimin e grave në zonat rurale të këtyre NJQV-ve.

3.5 Feedback-u i subjekteve

Gjatë kryerjes së projektit të auditimit, subjektet e përfshira në auditim, Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive dhe bashkitë: Shkodër Kukës, Lezhë, Dibër, Krujë, Elbasan, Kavajë, Divjakë, Lushnjë, Berat, Pogradec, Vlorë dhe Gjirokastrë, përgjithësisht u janë përgjigjur kërkesave për dokumentacion të grupit të auditimit, edhe pse në disa raste, përgjigjet janë dërguar jashtë afateve apo dokumentacioni i dërguar nuk ka qenë i plotë.

Dokumentacioni i vënë në dispozicion të grupit të auditimit, si dhe përgjigjet e marra nga pyetësorët gjatë fazës së terrenit, shërbyen për zhvillimin e pyetjeve të auditimit, nxjerrjen e konkluzioneve dhe hartimin e rekomandimeve përkatëse bazuar në fokusin e auditimit.

11. Strategjia Kombëtare për Barazinë Gjinore 2016-2020.

4

DETAJET E AUDITIMIT

4.1 Vlerësimi i risqeve të aktiviteteve të subjekteve

Risqet e aktivitetit të subjekteve, janë ato risqe me të cilat përballen institucionet e audituara për realizimin e përgjegjësive të tyre që krijohen nga aktiviteti në tërësi, duke u fokusuar në politikat, programet, proceset dhe strategjitë që ndjekin këto institucione për zhvillimin e grave të zonave rurale, duke i përfshirë në programet e punësimit si pjesë e të gjitha fazave të menaxhimit me qëllim integrimin e tyre në tregun e punës. Risqet e aktivitetit të subjekteve, janë analizuar dhe evidentuar në tabelën në vijim.

Fusha e aktivitetit	Përshkrimi i riskut	Ndikimi që mund të kenë risqet e identifikuara	Niveli i riskut	Pyetja e auditimit
Vlerësimi i programeve të punësimit.	Programet për nxitjen e punësimit, mund të mos jenë hartuar mbi baza gjinore apo mund të mos jenë vlerësuar nevojat e grave në zonat rurale.	Gratë e zonave rurale nuk janë të përfshira dhe, si pasojë, nuk përfitojnë nga programet e nxitjes së punësimit.	I lartë	A janë programet e nxitjes së punësimit të diversifikuara, të zbatuara në të gjithë vendin, për punësimin e grave në zonat rurale?
Hartimi i politikave në koherencë me nevojat e grupeve të interesit.	Gjatë hartimit të politikave apo programeve të punësimit nga strukturat përgjegjëse, mund të mos jenë marrë në konsideratë nevojat e grave specifikisht në zonat rurale. Strukturat përgjegjëse, mund të mos kenë kryer procesin e vlerësimit të nevojave përpara hartimit të politikave dhe programeve.	Gratë kryefamiljare hasin vështirësi në integrimin në tregun e punës, gjë e cila ndikon direkt në ekonominë e familjes. Programet e punësimit hartohen të përgjithshme dhe nuk përmirësojnë nivelin e punësimit të grave, veçanërisht në zonat rurale.		

Fusha e aktivitetit	Përshkrimi i riskut	Ndikimi që mund të kenë risqet e identifikuar	Niveli i riskut	Pyetja e auditimit
Infrastruktura në kuadër të zvogëlimit të pengesave për punësim.	Investimet në infrastrukturë (çerdhe, kopshte, transport publik), mund të jenë një faktor i rëndësishëm për nxitjen e punësimin të grave në zonat rurale.	Mungesa e kushteve apo e transportit, ndikon drejtpërsëdrejti në punësimin e grave dhe si pasojë, në mirëqenien e familjeve.	I lartë	A është investuar nga qeveria qendrore dhe vendore në përmirësimin e infrastrukturës, në kuadër të nxitjes së punësimin?
Ndërveprimi midis strukturave përgjegjëse.	Mekanizmi i bashkëpunimit midis strukturave në nivel qendror dhe vendor, mund të mos jetë ngritur ose mund të mos jetë efektiv.	Bashkëpunimi joefektiv, ndikon në identifikimin e gjendjes dhe të nevojave të grave në zonat rurale.	I lartë	A është monitoruar nga AKPA zbatimi i politikave të punësimin të grave në zonat rurale?
Monitorimi i rezultateve.	AKPA mund të mos ketë kryer monitorimin e zbatimit të programeve të punësimin, duke theksuar barazinë gjinore, përfshirë gratë e zonave rurale.	Mungesa e monitorimit mbi baza gjinore, ndikon në vendimmarrjen, sikurse është hartimi i programeve të punësimin apo marrja e masave që do të sjellin përmirësim.	I lartë	

4.2 Objektivat e auditimit

Auditimi me temë “Barazia gjinore dhe fuqizimi i grave nga zonat rurale, përmes përfshirjes në tregun e punës”, kishte si objektiva kryesore vlerësimin e politikave dhe efektivitetin e tyre në funksion të përmbushjes cilësore të shërbimeve të ofruara për nxitjen e punësimin të grave në zonat rurale, duke u fokusuar kryesisht në rolin dhe përgjegjësitë që subjektet nën auditim kanë në realizimin e objektivave të tyre institucionale. Në këtë mënyrë, grupi i auditimit synoi të sigurojë një vlerësim të paanshëm dhe objektiv të institucioneve të përfshira në auditim, në drejtim të:

1. Vlerësimin të programeve të nxitjes së punësimin, nëse këto programe kanë qenë të diversifikuara dhe të përshtatura për rajone të veçanta, mbi baza gjinore, si dhe nëse janë zbatuar në të gjithë vendin, në mënyrë eficiente dhe efektive, duke siguruar barazi gjinore;
2. Vlerësimin të programeve të nxitjes së punësimin për kategorinë që trajtohet me ndihmë ekonomike dhe pagesë papunësie, për të realizuar daljen nga skema e ndihmës ekonomike;
3. Vlerësimin të ofrimit të kushteve që lehtësojnë punësimin e grave nga zonat rurale, sikurse është investimi në shërbime publike, çerdhe dhe kopshte për fëmijët apo transport nga zonat rurale për në qendrat e punës;
4. Bashkëpunimit dhe koordinimit midis NJQV-ve dhe AKPA-ve rajonale/vendore në punësimin e grave, ku përfshihen edhe gratë në zonat rurale. Efektiviteti i marrëveshjeve të bashkëpunimit midis AKPA-s dhe NJQV-ve.
5. Monitorimit të zbatimit të politikave të punësimin dhe si është përdorur informacioni i gjeneruar nga ky proces në arritjen e qëllimeve.

4.3 Pyetjet e auditimit



4.4 Fushëveprimi i auditimit

Auditimi i Performancës me temë “*Barazia gjinore dhe fuqizimi i grave nga zonat rurale, përmes përfshirjes në tregun e punës*”, u përpoq të vlerësonte programet e nxitjes së punësimin nëse ato përfshijnë punësimin e grave nga zonat rurale. Gjithashtu, auditimi vlerësoi nëse strukturat përgjegjëse në nivel qendror dhe vendor, bashkëpunojnë midis tyre. Auditimi u zhvillua në 13 NJQV përkatësisht, bashkitë: Shkodër, Kukës, Lezhë, Dibër, Krujë, Elbasan, Kavajë, Divjakë, Lushnjë, Berat, Pogradec, Vlorë, Gjirokastër, dhe Agjencinë Kombëtare të Punësimin dhe Aftësive. Periudha nën auditim, ishte 2019-2023.

Referuar Ndhmës Ekonomike (NE), grupi i auditimit u fokusua vetëm në vlerësimin e ndikimit të programeve të punësimin në daljen nga skema e Ndhmës Ekonomike të grave dhe jo në auditimin e vetë skemës.

5

SHTJELLIMI I PYETJEVE TË AUDITIMIT

PYETJA KRYESORE

A përfshijnë politikat kombëtare punësimin e grave në zonat rurale?

MESAZHI I AUDITIMIT

Agjencia Kombëtare e Punësimin dhe Aftësive, duhet të intensifikojë bashkëpunimin me Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore për të identifikuar nevojat e grave rurale, si dhe më pas të hartojë programe të nxitjes së punësimin, në vlerësim të potencialit dhe aftësive të tyre në fusha të ndryshme, si bujqësia, shërbimet sociale, arsimit, teknologjia, etj.

Nxitja e programeve të punësimin në vlerën e diversitetit dhe kontributit të çdo anëtarit të komunitetit në ndërtimin e një shoqërie të fortë dhe të qëndrueshme, të hartuara dhe të zbatuara për gratë në vitet 2020-2023, janë të përgjithshme dhe nuk japin plotësisht, panoramën e gjithë rajoneve dhe referuar vlerësimin të nevojave. Infrastruktura vendore nuk nxit përfshirjen e grave rurale në tregun e punës, pasi në zonat rurale mungojnë çerdhet, ndërsa shërbimi i kopshteve nuk ofrohet në të gjitha njësitë administrative rurale, si dhe mungon transporti publik nga njësi qendër drejt të gjitha njësi administrative të bashkive.

5.1 A mundësojnë programet kombëtare punësimin aktiv të grave në zonat rurale?

Në vendin tonë roli i gruas në zonat rurale është ende në nivele të ulëta promovimi dhe mbështetjeje. Edhe pse janë ndërmarrë me dhjetëra projekte dhe iniciativa për të forcuar pozitën dhe rolin vendimmarrës të grave në zhvillimin rural, nuk ia kanë dalë të jenë në efektivitetin e duhur. Ndaj fuqizimit të grave në zonat rurale në Shqipëri, duhet synuar një klimë më mbështetëse, me iniciativa të mirëfillta dhe afatgjata, duke venë theksin në boshllëqet dhe në rolin që duhet të ketë grua në këto zona.

Tregjet rurale të punës, nuk ofrojnë shumë mundësi për gratë. Gratë dekurajohen nga kërkimi i punës jashtë fermës dhe punojnë në mënyrë mbizotëruese në bujqësi. Në fakt, një përqindje e lartë e grave kontribuon si punonjëse në familje, që do të thotë se e bëjnë ato punën e papaguar në ekonominë bujqësore të shtëpisë.

Adresimi i pengesave me të cilat përballen gratë dhe vajzat në zonat rurale, është një nga prioritetet e qeverisë shqiptare, si pjesë integrale e angazhimit të marrë për më shumë barazi gjinore dhe përfshirje sociale.

Në muajin mars 2019, u miratua Ligji i ri Nr. 15/2019, datë 13.03.2019 "Për Nxitjen e Punësimit". Ky ligj, hapi rrugën për ristrukturimin e Shërbimit Kombëtar të Punësimit në Agjencinë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive, rikonceptimin e marrëdhënieve me punëdhënësit, krijimin e një sistemi informacioni të tregut të punës dhe të tjerë. Bazuar në këtë ligj, politikat publike të punësimit përfshijnë shërbimet e punësimit dhe programet aktive e pasive të tregut të punës, të cilat synojnë nxitjen e punësimit të punëkërkuësve të papunë, integrimin dhe përfshirjen sociale të grupeve të veçanta. Ky ligj parashikon zbatimin e programeve të reja të nxitjes së punësimit, që përfshijnë angazhimin e punëkërkuësve të papunë në programe të ndryshme punësimi¹² si: formimin nëpërmjet punës, praktikën profesionale, vetëpunësimin, punësimin në komunitet, për të cilat parashikohet subvencionim në përqindje të caktuar të kostove për: sigurimet e detyrueshme shëndetësore dhe shoqërore, pagat, pajisjen e vendit të punës dhe përshtatjen e arsyeshme, transport për në vendin e punës, ndjekjen e kopshteve dhe çerdheve për fëmijët në ngarkim, përkatësisht sipas programeve.

Programet e nxitjes së punësimit, janë miratuar me VKM-të e nxitjes së punësimit dhe kanë qenë subjekt i ndryshimeve të vazhdueshme ndër vite sipas prioriteteve të Qeverisë për rritjen e nivelit të punësimit. Programet e nxitjes së punësimit, janë zbatimi i politikave shtetërore të punësimit për të mbështetur punëkërkuësit si edhe punëdhënësit, për të krijuar vende të reja pune të qëndrueshme. Ato përfshijnë angazhimin e punëkërkuësve të papunë në programe të ndryshme punësimi, punësh publike, vetëpunësimi, praktikash profesionale apo trajnimi nëpërmjet punës, për të cilat parashikohet subvencionim sipas akteve ligjore përkatëse.

Politikat për nxitjen e punësimit në vendin tonë, zbatohen nëpërmjet Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive.

- Konkretisht për periudhën nën auditimin për mbështetjen e punëkërkuësve të papunë me programet aktive të Nxitjes së Punësimit, Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive, ka zbatuar katër VKM-të e mëposhtme:
- Vendimin Nr. 17, datë 15.01.2020 "Për procedurat, kriteret dhe rregullat për zbatimin e programeve të nxitjes së punësimit nëpërmjet punësimit, formimit në punë dhe praktikave profesionale", i ndryshuar;
- Vendimin Nr. 348, datë 29.4.2020 "Për procedurat, kriteret dhe rregullat për zbatimin e programit të nxitjes nëpërmjet Vetëpunësimit";
- Vendimin Nr. 535, datë 8.7.2020 "Për procedurat, kriteret dhe rregullat për zbatimin e Programit të Punëve Publike në Komunitet";

Vendimin Nr. 608, datë 29.07.2020 "Për procedurat, kriteret dhe rregullat për zbatimin e programit të nxitjes së punësimit të personave të dalë të papunë si pasojë e COVID-19", i ndryshuar.

Programet e nxitjes së punësimit, janë konceptuar në formë të tillë, që të adresojnë edhe nevojat e kategorive të disavantazuara të punëkërkuësve të papunë.

- VKM-ja e parë, parashikon zbatimin e programeve të nxitjes së punësimit për:

12. Në Nenin 23, pika 4, përcaktohet se: "Aktet nënligjore, në zbatim të ligjit nr. 7995, datë 20.9.1995, "Për nxitjen e punësimit", të ndryshuar, mbeten në fuqi deri në miratimin e akteve të reja nënligjore, në zbatim të këtij ligji, për sa kohë nuk bien në kundërshtim me parashikimet e këtij ligji".

- programin e punësimit,
- formimin nëpërmjet punës, dhe praktikat profesionale
- Qëllimi i këtyre programeve është punësimi, formimi apo praktikat profesionale për punëkërkuessit e papunë, të cilët e kanë të vështirë të dalin në tregun e punës. Në këto programe, nevojat dhe profili i punëkërkuessit, duhet të përshtaten me profilin e vendit të lirë të punës, të ofruar nga punëdhënësi.
- VKM-ja e dytë (Programi i vetëpunësimit) përcakton procedurat, kriteret dhe rregullat për zbatimin e programit të vetëpunësimit, i cili ka si qëllim nxitjen e vetëpunësimit dhe krijimin e sipërmarrjeve dhe bizneseve të reja të punëkërkuessve.

VKM-ja e tretë (Programi i punës në komunitet) ka si qëllim ofrimin e punëve dhe shërbimeve në favor të komunitetit, duke trajnuar punëkërkuessit, në zonat vendore dhe gjeografike të disavantazuara. Në çdo VKM (Dispozitat e fundit), përcaktohet se vlerësimi i ndikimit të programeve, kryhet çdo katër vjet nga ministria përgjegjëse për çështjet e punësimit nëpërmjet ekspertëve ose organizatave me përvojë në këtë fushë. Afat i cili, ende nuk është përmbyshur dhe për rrjedhojë, nuk ka një vlerësim të ndikimit të këtyre programeve të nxitjes së punësimit. Gjithsesi, AKPA, në kuadër të vlerësimit të brendshëm institucional, duhet të kryejë nëpërmjet strukturave të saj procesin e gjurmimit të përfituesve të programeve të nxitjes së punësimit, me fokus të veçantë përlllogaritjen e nivelit të punësueshmërisë post-nxitje dhe matjen e nivelit të relevancës së këtyre programeve, referuar llojit të profesionit dhe rrogës së punësimit aktual. Ky proces konkretizohet nëpërmjet raporteve vjetore të gjurmimit të pjesëmarrësve në program. Prej vitit 2022, AKPA ka filluar të realizojë procesin e pjesëmarrësve në programet e nxitjes së punësimit dhe ka publikuar vetëm një raport, atë të gjurmimit post-nxitje për të gjithë pjesëmarrësit e programeve të nxitjes së punësimit që kishin përfituar programe gjatë vitit 2020, të realizuar në vitin 2022 dhe të publikuar në vitin 2023.

Procesi i gjurmimit për të gjithë pjesëmarrësit në VKM-në Nr. 17 dhe VKM-në Nr. 608, të cilët i nisën programet në vitin 2020, është realizuar nga AKPA nëpërmjet Sektorit të Programeve Aktive dhe Pasive, si edhe nëpërmjet ZVAKPA-t në çdo rajon. Faza e anketimit/gjurmimit e nisur në muajin mars 2022, ka përfunduar në muajin korrik 2022. Ky proces është bazuar në Nenin 15 të Rregullores Nr. 6 Prot., datë 21.10.2020 “Për zbatimin e programeve të nxitjes së punësimit, formimit në punë dhe praktikave profesionale”, e ndryshuar, (rregullore e VKM-së Nr. 17), në Nenin 15, të Rregullores Nr. 5 Prot., datë 09.10.2020 “Për procedurat, kriteret dhe rregullat për zbatimin e programit të nxitjes së punësimit nëpërmjet punësimit të personave të dalë të papunë si pasojë e COVID-19”, e ndryshuar (rregullore e VKM-së Nr. 608), ku përcaktohet se, gjashtë muaj pas përfundimit të programit, Struktura Rajonale e Punësimit realizon ndjekjen e statusit në punësim të pjesëmarrësve, nëpërmjet sistemit të tatimeve apo telefonatave, si dhe në Nenin 9 të Rregullores së VKM-së Nr. 17, ku përcaktohet se procesi i gjurmimit, duhet të realizohet edhe për kandidatët jopjesëmarrës nga grupi i kontrollit (minimalisht 25% të numrit të pjesëmarrësve në programe). Fillimisht, u ndërtua formati/template për ndjekjen e statusit në punësim të pjesëmarrësve 6 muaj pas përfundimit të programeve. Formatin e gjurmimit, parashikonte verifikimin nëpërmjet sistemit të tatimeve apo telefonatave të statusit të punësimit, si dhe siguronte një mori të dhënash mbi vlerësimin e programeve. Këto të dhëna mbledhen dhe përpunohen nëpërmjet një databaze dhe përdoren për të matur efektivitetin e programeve. Sektori i PAPTP në bashkëpunim me Drejtorinë e Planifikimit dhe Performancës, kanë përpunuar të dhënat dhe kanë ndërtuar raportin e gjurmimit. Për të përmbyshur këtë aktivitet lidhur me çështjet gjinore, fokusi i AKPA-s ka qenë vetëm në vlerësimin e nivelit të punësueshmërisë sipas gjinive për çdo tregues. Sa më sipër, në Raportin e Gjurmimit për pjesëmarrësit në PNP gjatë vitit 2020, i cili u finalizua në vitin 2022, janë paraqitur rezultatet e gjurmimit të disagreguar sipas gjinisë (femra/meshkuj) për çdo tregues, ku rezulton se vajzat dhe gratë e regjistruara, kanë një nivel më të lartë punësueshmërie pas përfundimit të programeve, në krahasim me djemtë/burrat.

Aktualisht, AKPA është në fazën e hartimit të raportit të dytë të gjurmimit, i cili do të paraqesë rezultatet e punësueshmërisë së pjesëmarrësve në PNP gjatë vitit 2021. **Por, nga intervistat me strukturat**

drejtuese të AKPA-s dhe nga analizimi i të dhënave të vëna në dispozicion, rezulton se rezultatet e gjurmimit, nuk janë mundur të ndahen dhe të na japin të dhëna mbi nivelin e punësimit të grave në zonat rurale. AKPA duhet të masë dhe analizojë nivelin e rezultateve të punësimit nga këto programe, për të gjykuar efektivitetin e tyre edhe në zonat rurale.


Fuqizimi ekonomik i grave në zonat rurale, është shumë i rëndësishëm për zhvillimin e vendit, për forcimin e rolit në zhvillimin dhe komunitetin rural. Për të përballuar sfidat e pabarazisë gjinore, nevojitet që grave rurale t'u ofrohet akses në shërbime, akses në financë, për t'u dhënë mundësi atyre të informohen për çdo gjë që lidhet me risitë teknologjike në fushën e bujqësisë, me aftësimin në kulinari tradicionale, në drejtim të bujtinave, etj.

Viti 2023

Referuar të dhënave zyrtare të publikuara nga INSTAT në tremujorin e tretë të vitit 2023, shkalla e punësimit për popullsinë 15-64 vjeç është 67,7 %. Gjatë këtij tremujori, numri i të punësuarve gjithsej, është rritur me 1,6 %, krahasuar me tremujorin e tretë të vitit 2022, dhe me 0,5 %, krahasuar me tremujorin e dytë të vitit 2023. Shkalla zyrtare e papunësisë në Shqipëri, arriti në 10,5%, në tremujorin e tretë të vitit 2023. Në tremujorin e tretë të vitit 2023, shkalla zyrtare e papunësisë në Shqipëri, për popullsinë 15 vjeç e lart, është 10.5 %, duke pësuar rënie me 0,03 pikë përqindje, krahasuar me të njëjtin tremujor të vitit 2022 dhe është ulur me 0,2 pikë përqindje, krahasuar me tremujorin e mëparshëm.

Në tremujorin e tretë të vitit 2023, shkalla e pjesëmarrjes në forcat e punës, për popullsinë 15-64 vjeç, është 76,1 %. Krahasuar me tremujorin e tretë të vitit 2022, shkalla e pjesëmarrjes në forcat e punës është 2,7 pikë përqindje më e lartë, ndërkohë që krahasuar me tremujorin e mëparshëm, është rritur me 0,3 pikë përqindje.

Figura 1 : Shkalla e pjesëmarrjes në forcat e punës për popullsinë 15 - 64 vjeç. Tr.3/19-Tr.3/23



Burimi: INSTAT


Për gratë, shkalla e pjesëmarrjes në forcat e punës është 70,2 %, ndërsa për burrat, ky tregues është 82,2 %. Për burrat, shkalla e pjesëmarrjes në forcat e punës është 12,1 pikë përqindje më e lartë sesa për gratë. Krahasuar me të njëjtin tremujor të vitit 2022, shkalla e pjesëmarrjes në forcat e punës për gratë, është rritur me 2,8 pikë përqindje dhe për burrat me 2,5 pikë përqindje. Gjatë tremujorit të tretë të vitit 2023, shkalla e pjesëmarrjes në forcat e punës për të rinjtë e moshës 15-29 vjeç është 57,5%.

Ky tregues është rritur me 2,6 pikë përqindje, krahasuar me tremujorin e tretë të vitit 2022, dhe është rritur me 0,8 pikë përqindje në krahasim me tremujorin e dytë të vitit 2023. Për popullsinë 30-64 vjeç, në tremujorin e tretë të vitit 2023, shkalla e pjesëmarrjes në forcat e punës është 84.6%.

Punësimi

Gjatë tremujorit të tretë të vitit 2023, shkalla e punësimit për popullsinë 15-64 vjeç është 67,7 %. Numri i të punësuarve për popullsinë 15 vjeç e lart, nga tremujori i tretë i vitit 2022 në tremujorin e tretë të vitit 2023, është rritur me 1,2 %. Në terma vjetorë, punësimi ulet me 3,0% në sektorin e bujqësisë dhe me 2,0% në sektorin e industrisë, ndërsa u rrit me 6,1% në sektorin e shërbimeve. Krahasuar me tremujorin e mëparshëm, në tremujorin e tretë të vitit 2023, punësimi për popullsinë 15 vjeç e lart u rrit me 1,1 %. Punësimi ulet me 2,5 % në sektorin e industrisë dhe me 1,3 në sektorin e shërbimeve, ndërsa u rrit me 7,3 në sektorin e bujqësisë.


Figura 2: Ndryshimi vjetor dhe tremujor i punësimit për popullsinë 15 vjeç e lart



Burimi: INSTAT

Shkalla e punësimit për burrat e grup-moshës 15-64 vjeç është 73,4 %, ndërsa për gratë është 62,2 %. Krahasuar me të njëjtin tremujor të vitit 2022, shkalla e punësimit është rritur për burrat me 1,7 pikë përqindje, ndërsa për gratë është rritur me 2,7 pikë përqindje. Në tremujorin e tretë të vitit 2023 shkalla e punësimit të të rinjve është 44,8 %. Krahasuar me tremujorin e tretë të vitit 2022, shkalla e punësimit të të rinjve është rritur me 1,1 pikë përqindje dhe në krahasim me tremujorin e dytë të vitit 2023 është rritur me 0,7 pikë përqindje. Për popullsinë 30-64 vjeç, në tremujorin e tretë të vitit 2023, shkalla e punësimit është 78,2 %.

Figura 3: Shkalla e punësimit për popullsinë 15 - 64 vjeç. Tr.3/19-Tr.3/23




Burimi: INSTAT

Papunësia

Në tremujorin e tretë të vitit 2023, shkalla zyrtare e papunësisë në Shqipëri është 10,5 %. Shkalla zyrtare e papunësisë është ulur me 0,03 pikë përqindje, në krahasim me tremujorin e tretë të vitit 2022, dhe me 0,2 pikë përqindje, krahasuar me tremujorin e dytë të vitit 2023. Shkalla zyrtare e papunësisë për burrat është 10,1 % dhe për gratë 11,1 %. Krahasuar me të njëjtin tremujor të vitit 2022, shkalla e papunësisë është rritur me 0,2 pikë përqindje për burrat dhe është ulur me 0,2 pikë përqindje për gratë.

Figura 4: Shkalla e punësimit për popullsinë 15 vjeç e lart




Burimi: INSTAT

Shkalla zyrtare e papunësisë për të rinjtë 15–29 vjeç është 22,0 %. Krahasuar me tremujorin e tretë të vitit 2022, shkalla e papunësisë për të rinjtë, është rritur me 1,6 pikë përqindje. Krahasuar me tremujorin e dytë të vitit 2023, ky tregues është ulur me 0,3 pikë përqindje. Shkalla e papunësisë për grup-moshën 30–64 vjeç është 7,6 %. Në terma vjetorë, ky tregues është ulur me 0,1 pikë përqindje dhe krahasuar me tremujorin e mëparshëm ka një ulje me 0,1 pikë përqindje.

Popullsia ekonomisht joaktive

Gjatë tremujorit të tretë të vitit 2023, 16,4 % e popullsisë ekonomisht joaktive dhe në moshë pune (15–64 vjeç), ishin duke përmbushur detyrat shtëpiake, 9,7 % e saj ishte në pension ose pension të parakohshëm, ndërsa 13,4 % në paafësi të përhershme. Gjatë tremujorit të tretë të vitit 2023, 4,7 % e popullsisë ekonomisht joaktive (në grup-moshën 15–64 vjeç), deklaruan se nuk po kërkonin punë pasi besonin se nuk ka punë të disponueshme, pra klasifikohen si të papunë të dekurajuar.

Figura 5: Struktura e popullsisë ekonomisht jo-aktive sipas gjinisë dhe statusit, popullsia 15–64 vjeç




Burimi: INSTAT

Të rinjtë e moshës 15-29 vjeç që deklaruan se janë nxënës/studentë ose në trajnim, përbëjnë 69,6 % të të rinjve ekonomikisht joaktivë. Ndër të rinjtë e moshës 15-29 vjeç ekonomikisht joaktivë, 2,5 % klasifikohen si të papunë të dekurajuar. Në popullsinë e moshës 30-64 vjeç, ky grup përbën 22,0 % të popullsisë ekonomikisht joaktive të kësaj grup-moshe.

Ndërkohë, për sa i përket punëkërkuesve të papunë, të cilët janë regjistruar në Zyrat e Punësimit për të përfituar nga programet e AKPA-s (referuar analizave vjetore të AKPA-s për vitet 2019-2022), rezulton se shifrat e papunësisë së regjistruar, janë si më poshtë:


Figura 6: Mesatarja vjetore e papunësisë sërregjistruar në vite



Burimi: AKPA


Gjatë vitit 2022 numri mesatar i Pu.Pa-ve të regjistruar në Zyrat e Punës, ishte 76,879 individë. Vihet re se, një pjesë e konsiderueshme e regjistrimit të Pu.Pa-ve, përbëhet nga persona të cilët përfshihen në një ose më shumë grupe të veçanta, ku më shumë se gjysma, përbëhet nga kategoria e grave.

Figura 7: Papunësia (Stock) 2022



Burimi: AKPA

Procesi i integritimit të Pu.Pa-ve në tregun e punës, has pengesa të ndryshme lidhur me aftësitë, moshën, statusin social etj. Si rezultat, rreth 95% e punëkërkuesve të papunë identifikohen në nivelin e dytë dhe të tretë të punësueshmërisë.



Burimi: AKPA

Duke e analizuar regjistrin e Pu.Pa-ve sipas moshës dhe arsimit, vihet re se, rreth 48% e totalit të Pu.Pa-ve janë mbi 45 vjeç dhe 55% me arsim deri 9-vjeçar, çka e vështirëson integrimin e këtyre Pu.Pa-ve në tregun e punës. Kjo tendencë, është më e theksuar në grupet e veçanta.

Gjatë vitit 2022, nga totali i përfituesve të rinj (2813) të programeve të nxitjes së punësimit, kanë përfituar nga kategoritë e veçanta si më poshtë:

- Persona me aftësi të kufizuar (PAK) 24 persona
- Romë/Egjiptianë 213 persona ose 76% më shumë se viti 2021
- Ndihmë Ekonomike (NE) 543 persons ose 167 % më shumë se viti 2021
- Pagesë Papunësie 127 persona

Gjatë këtij viti, AKPA ka vijuar të zbatojë VKM-në Nr. 348 për Vetëpunësimin, e cila referuar analizave institucionale, ka rezultuar një ndër programet më të kërkuara nga punëkërkuarit e papunë. Nga ky program, për vitin 2022 kanë përfituar 242 punëkërkuar të papunë ose gati 5 herë më tepër se gjatë vitit 2021, ku numri i përfituesve ishte 44 persona.

Në të njëjtën kohë gjatë vitit 2022, vijoi të zbatohet programi i Punëve Publike në Komunitet i nisur në vitin 2021, i cili është një program i dedikuar dhe i përshtatur për kategoritë e vështira dhe punëkërkuarit e papunë afatgjatë, të cilët e kanë të vështirë të integrohen në tregun e punës. Në këtë program, numri i përfituesve ishte 1,060 persona ose gati 5 herë më tepër se numri i përfituesve të vitit 2021.

Indikatorët e përdorur dhe analizuar nga AKPA, nuk ndahen në gra në fshat apo gra në qytet, por të dhënat e referuara dhe analizimi i tyre, është për gratë në përgjithësi.

Programet e Nxitjes së Punësimit

Viti 2019

Për periudhën janar-dhjetor 2019, nga zbatimi i programeve të nxitjes për vitin 2019, kanë përfituar 600 subjekte dhe 5,338 individë, nga të cilët 325 subjekte dhe 2,749 individë, janë aplikimet e vitit të mëparshëm.

Nëse do të shohim zbatimin e programeve për vitin 2019, kemi një paraqitje të realizimit të fondit të ndarë sipas VKM-ve, si më poshtë:

VKM	Numri i projekteve	Numri i punëkërkesve të papunë	Fondi i konfirmuar për vitin buxhetor
27	10	26	3.228.919
47	87	1143	101,961,768
48	167	1282	183,825,400
64	0	0	16,008
199	14	20	2,660,245
248	47	58	11,560,888
873	242	1379	49,717,406
162	33	1430	21,766,031
TOTAL	600	5338	374,736,665

Burimi: AKPA

Nëse shohim realizimin sipas VKM-ve, duke e krahasuar me fondin e realizuar, shtrirjen më të madhe e kanë programet me VKM-në 48, të cilat zënë 49% të totalit dhe më pas programet me VKM-në 47 me 27% të totalit. Nëse analizojmë përfshirjen e punëkërkesve të papunë në programet e nxitjes së punësimit sipas grupeve të veçanta, kemi: Femra 3,045 Pu.Pa apo 57% e totalit të pjesëmarrësve,

- Rreth 6% nga ndihma ekonomike,
- Rreth 8% nga ish-përfituesit e ndihmës ekonomike,
- 17% punëkërkes të papunë afatgjatë,
- 1% Romë, 3% Egjiptianë,
- 2% persona me aftësi të kufizuar,
- më shumë se 1% emigrantë të kthyer.

Me hyrjen në fuqi të ligjit të ri nr. 15/2019 "Për Nxitjen e Punësimit", nga tetë VKM-të e sipërcituara që zbatoheshin në kuadër të PNP, gjatë vitit 2019, u zbatuan vetëm VKM-ja nr. 873 dhe VKM-ja nr.162. Si rrjedhojë, u rishikua fondi i alokuar për këto programe. Në Kartën e Treguesve të Monitorueshëm, u parashikua përfshirja e 1,700 punëkërkesve të papunë, prej të cilës është realizuar përfshirja në PNP e 2,589 punëkërkesve të papunë.

Pagesa e papunësisë

Në zbatim të VKM-së Nr. 161/2018 "Për Pagesën e së Ardhurës nga Papunësia", si dhe udhëzimit Nr. 17/2018 në zbatim të këtij vendimi, është realizuar ndjekja dhe monitorimi i pagesës së papunësisë nëpërmjet të gjitha kanaleve të komunikimit, si telefon, e-mail, si dhe vizita në terren. Gjatë 6-mujorit të parë të vitit 2019, fondi i pagesës së papunësisë u rrit, si rezultat i mbylljes së kompanive të basteve, si dhe nga rritja e nivelit të pagës minimale në shkallë vendi. Në skemën e pagesës së papunësisë gjatë periudhës 12-mujore të vitit 2019, kanë hyrë mesatarisht 521 përfitues çdo muaj, ku peshën specifike më të madhe, e zënë personat që vijnë nga zvogëlimi i aktivitetit ose prishja e kontratave

të punës. Si rezultat i mbarimit të afatit të trajtimit, nga skema e pagesës së papunësisë, kanë dalë mesatarisht 490 përfitues çdo muaj ose 85 % e totalit të mesatares mujore. Nga skema e pagesës së papunësisë për periudhën 12-mujore, janë punësuar 885 punëkërkuar të papunë, ku peshën specifike me të madhe e zënë zyrtar rajonale të punësimit si: Tiranë, Vlorë, Elbasan dhe Korçë. Gjithashtu, gjatë vitit 2019, nga kategoria e pagesës së papunësisë, janë përfshirë në PNP 25 Pu.Pa dhe kanë ndjekur kurset e formimit profesional 48 Pu.Pa.

Viti 2020

Nga zbatimi i programeve të nxitjes së punësimit për periudhën janar-dhjetor 2020, kanë përfituruar 751 subjekte dhe 4,146 individë, nga të cilët 171 subjekte dhe 1,319 individë, janë aplikimet e vitit të mëparshëm. Nëse do të shohim zbatimin e programeve për vitin 2020, kemi një paraqitje të realizimit të fondit të ndarë sipas VKM-ve, si më poshtë:

VKM	Numri i projekteve	Numri i punëkërkuarve të papunë	Fondi i konfirmuar për vitin buxhetor
VKM 17 (Programi i punësimit)	162	341	510,363
V.K.M 17 (Programi 2 Formimi nëpërmjet punës)	90	273	2,221,986
V.K.M 17 (Programi 3 Praktikat e punës)	85	491	1,279,678
V.K.M 608 (Programi 4-mujor)	3	30	606,265
V.K.M 608 (Programi 8-mujor)	125	1129	26,381,493
V.K.M 608 (Programi 12-mujor / Informaliteti)	115	563	792,957
VKM 873	161	171	26,784,626
VKM 162	10	602	11,854,181
TOTAL	751	4146	70,431,549.00

Burimi: AKPA

Nga totali i pjesëmarrësve në PNP gjatë vitit 2020, rreth 67% e tyre ishin femra dhe 52% të rinj të moshës 16-26 vjeç.

Programet e reja të Nxitjes së Punësimit

Për zbatimin e programeve të reja për vitin 2020, në raport edhe me miratimin e VKM-ve të reja, AKPA ka zhvilluar një sërë trajnimesh për stafin lidhur me paketat e programeve të nxitjes së punësimit në çdo zyrë vendore punësimi. Në fund të muajit Gusht 2020, nisën procedurat për zbatimin e VKM-ve të reja të nxitjes së punësimit. Gjatë këtij viti, në programet e reja të PNP-së, u përfshinë 580 subjekte dhe 2,827 punëkërkuar të papunë. Rreth 58 % e subjekteve u përfshinë në programet e VKM-së Nr. 17, ndërsa 61% e punëkërkuarve të papunë përfitues, morën pjesë në programet e VKM-së Nr. 608.

Viti 2021

Gjatë vitit 2021 vijoi zbatimi i programeve të VKM-së Nr. 17 dhe VKM-së Nr. 608, si dhe nisi zbatimi për herë të parë i VKM-së Nr. 535 "Punët Publike në Komunitet" dhe VKM-së Nr. 348 "Vetëpunësimi". Gjatë këtij viti, u punësuan dhe vetëpunësuan me programet e nxitjes së punësimit 1,610 Pu.Pa. Gjatë vitit 2021, u punësuan 3,184 Punëkërkuar të Papunë nga skemat e mbështetjes me të ardhura (rreth 47% e databazës së përfituesve të pagesës së papunësisë dhe 4% e databazës së përfituesve të ndihmës ekonomike).

Në fund të vitit 2021, rezultojnë se nga 45,125 Punëkërkuar të Papunë Femra të regjistruar gjithsej, kanë arritur të punësohen 11,677 prej tyre, ose 14% më pak se një vit më parë. Ndërsa nga 33,340 Pu.Pa., Kryefamiljarë, kanë arritur të punësohen vetëm 7,699 prej tyre ose 22% më shumë se një vit më parë.

Viti 2022

Për periudhën janar-dhjetor 2022 nga zbatimi i programeve të nxitjes për vitin 2022 kanë përfituar **1,278** subjekte dhe **4,344** individë, nga të cilët **477** subjekte dhe **1,531** individë, janë aplikimet e vitit 2021 (të mbarturit). Nëse do të shohim zbatimin e programeve për vitin 2022, kemi një paraqitje të realizimit të fondit të ndarë sipas VKM-ve, si më poshtë:

VKM	Numri i projekteve	Numri i punëkërkesve të papunë	Fondi i harxhuar për vitin buxhetor (në milionë lekë)
V.K.M 17 (Programi 1 Punësimi)	266	523	43.9
V.K.M 17 (Programi 2 Formimi nëpërmjet punës)	150	338	35.4
V.K.M 17 (Programi 3 Praktikat e punës)	229	929	59.2
V.K.M 608 (Programi 4-mujor)	9	20	1.8.
V.K.M 608 (Programi 8-mujor)	106	515	69.2
V.K.M 608 (Programi 12-mujor / Informaliteti)	163	466	35.5
V.K.M 535 (Punët në komunitet)	69	1267	144.5
V.K.M 348 (Programi i vetëpunësimit)	286	286	58.8
TOTAL	1,278	4,344	448.2

Burimi: AKPA

Nga totali i pjesëmarrësve në PNP gjatë vitit 2022, rreth 59% e tyre ishin femra dhe 41% të rinj të moshës 16-26 vjeç.

	Programet e mbartura		Programet e reja		Total programe të zbatuara	
	Vlera	%	Vlera	%	Vlera	%
Pjesëmarrës në PNP prej tyre	1531	100%	2813	100%	4344	100%
Femra	800	52%	1773	63%	2573	59%
të rinjtë 16-29 vjeç	661	43%	1133	40%	1794	41%
nga pagesa e papunësisë	50	3%	127	5%	177	4%
nga ndihma ekonomike	149	10%	543	19%	692	16%
romë/egjiptianë	91	6%	213	8%	304	7%
PAK	24	2%	24	1%	48	1%
Emigrantë të kthyer	0	0%	17	1%	17	0%

Burimi: AKPA

Programet e reja të nxitjes të Punësimit (përfituesit e rinj të vitit 2022)

Gjatë vitit 2022, në programet e reja të PNP-së u përfshinë 801 subjekte dhe 2,813 punëkërkues të papunë. Rreth 54% e subjekteve u përfshinë në programet e VKM-së Nr. 17, ndërsa 10% e punëkërkuesve të papunë përfitues, morën pjesë në programet e VKM-së Nr. 608. Rreth 30% e subjekteve pjesëmarrëse, ishin subjekte të çelura dhe mbështetura me programin e vetëpunësimit.

VKM	Nr. Projektsh	Nr. Pjesëmarrësish
V.K.M 17 (Programi 1 Punësimi)	170	387
V.K.M 17 (Programi 2 Formimi nëpërmjet punës)	115	275
V.K.M 17 (Programi 3 Praktikat e punës)	144	637
V.K.M 608 (Programi 4-mujor)	2	3
V.K.M 608 (Programi 8-mujor)	23	53
V.K.M 608 (Programi 12-mujor / Informaliteti)	57	156
V.K.M 535 (Punët në komunitet)	48	1,060
V.K.M 348 (Programi i vetëpunësimit)	242	242
TOTAL	801	2813

Burimi: AKPA

Rreth 59% e numrit të pjesëmarrësve, paraqiten në rajonet Tiranë, Durrës, Fier, Elbasan dhe Shkodër.

Rajonet	Nr. Pjesëmarrësish	%
Berat	163	6%
Dibra	139	5%
Durrës	318	11%
Elbasan	256	9%
Fier	251	9%
Gjirokastra	237	8%
Korça	149	5%
Kukës	119	4%
Lezha	103	4%
Shkodra	304	11%
Tirana	541	19%
Vlora	233	8%
TOTAL	2,813	100%

Burimi: AKPA

Numri më i lartë i subjekteve që kanë aplikuar për pjesëmarrje në VKM-në Nr. 17 (punësimi dhe formimi nëpërmjet punës), ishte në aktivitetet ekonomike:

- Tregti;
- Akomodim dhe shërbim ushqimor;
- Industri përpunuese.

Praktikat profesionale janë zhvilluar më tepër në subjekte të cilat kanë si aktivitet ekonomik shërbimet administrative dhe mbështetëse, shëndetësi dhe aktivitetet e mbrojtjes sociale. Subjektet pjesëmarrëse në VKM-në Nr. 608, paraqiten më së shumti në industrinë përpunuese, akomodimin dhe shërbimin ushqimor, ndërtim dhe tregti. Në programin “Punët në komunitet”, janë përfshirë subjekte dhe OJF me aktivitet ekonomik akomodimin dhe shërbimin ushqimor, aktivitete të organizatave dhe organizmave eksterritoriale, dhe aktivitete shërbimesh të tjera. Përfituesit e programit “Vetëpunësimi”, u përqendruan në aktivitete ekonomike si: tregtia, aktivitetet e tjera të shërbimit, akomodimi dhe shërbimi ushqimor, arte, argëtim dhe çlodhje.

Aktivitetet ekonomike	VKM 17 (Punësimi)	VKM 17 (Programi 2 Formimi nëpërmjet punës)	VKM 17 (Programi 3 Praktikat e Punës)	VKM 348 (Programi vetëpunësimi)	VKM 535 (Punatë komunitete)	VKM 608 (12-mj.)	VKM 608 (4-mj.)	VKM-608 (8-mj.)
Akomodimi dhe shërbimi ushqimor	21%	34%	3%	10%	0%	28%	0%	26%
Aktivitete financiare dhe sigurimesh	5%	0%	5%	0%	4%	0%	0%	9%
Aktivitete profesionale, shkencore dhe teknike	2%	0%	1%	7%	0%	0%	0%	0%
Aktivitete shërbimesh të tjera	21%	32%	13%	38%	17%	7%	0%	17%
Aktivitete të organizatave dhe organizmave eksterritoriale	1%	0%	6%	0%	15%	0%	0%	0%
Arsim	1%	0%	7%	1%	2%	5%	0%	0%
Arte, argëtim dhe çlodhje	1%	0%	1%	11%	2%	0%	0%	0%
Bujqësi, Pyjet, Peshkim	1%	1%	0%	2%	0%	0%	0%	0%
Furnizimi me ujë	0%	0%	1%	0%	0%	0%	0%	0%
Industria nxjerrëse	1%	0%	0%	0%	0%	0%	0%	0%
Industria përpunuese	9%	12%	3%	1%	0%	35%	100%	26%

Informacion dhe komunikacion	1%	0%	0%	0%	0%	2%	0%	0%
Ndërtim	3%	3%	1%	1%	0%	5%	0%	4%
Shëndetësia dhe aktivitete të punës sociale	7%	2%	26%	7%	10%	2%	0%	0%
Shërbime administrative dhe mbështetëse	1%	0%	30%	2%	50%	0%	0%	0%
Transport dhe magazinim	1%	1%	1%	0%	0%	2%	0%	0%
Tregti me shumicë dhe pakicë; riparim mjetesh motorike dhe motoçikletash	26%	16%	3%	20%	0%	14%	0%	17%
TOTAL	100%	100%	100%	100%	100%	100%	100%	100%

Burimi: AKPA

Kategoritë si femrat, pagesa e papunësisë, ndihma ekonomike dhe romë/egjiptianët, janë përfshirë më tepër në programin e VKM-së Nr. 535 dhe duke vijuar me programet e VKM-së Nr. 17. Punëkërkuësit e papunë nga aftësia e kufizuar, kanë përfituar më tepër nga programi i punësimit dhe praktikave të punës nëpërmjet VKM-së Nr. 17 (86% e totalit).

	Total	Femra	Pagesë papunësie	Ndihma ekonomike	Romë/egjiptianë	PAK
V.K.M 17 (Punësimi)	12%	12%	4%	5%	7%	65%
V.K.M 17 (Formimi nëpërmjet punës)	8%	8%	1%	3%	2%	2%
V.K.M 17 (Praktikat e punës)	21%	27%	10%	10%	2%	19%
V.K.M 608 (Programi 4-mujor)	0%	0%	1%	0%	1%	0%
V.K.M 608 (Programi 8-mujor)	12%	11%	22%	1%	2%	4%
V.K.M 608 (Informaliteti)	11%	11%	2%	3%	2%	0%
V.K.M 535 (Punët në komunitet)	29%	26%	59%	78%	81%	8%
V.K.M 348 (Vetëpunësimi)	7%	5%	1%	1%	3%	2%
TOTAL	100%	100%	100%	100%	100%	100%

Burimi: AKPA

Pagesa e papunësisë

Gjatë vitit 2022, vihet re një rënie e ndjeshme e numrit të përfituesve të pagesës së papunësisë, nga 2,914 Pu.Pa përfitues që rezultojnë në muajin janar 2022, ky numër u ul në 2,307 Pu.Pa në muajin dhjetor 2022. Në skemën e pagesës së papunësisë gjatë periudhës 12-mujore të vitit 2022, kanë hyrë mesatarisht 418 përfitues çdo muaj, ku peshën specifike më të madhe, e zënë personat që vijnë nga zvogëlimi i aktivitetit ose prishja e kontratave të punës. Si rezultat i mbarimit të afatit të trajtimit, nga skema e pagesës së papunësisë, kanë dalë mesatarisht 468 përfitues çdo muaj.

Bazuar në periudhën e përfitimit, vëmë re se numri më i lartë vazhdon t'i përkasë periudhës së përfitimit prej 12 muajsh. Kjo për dy arsye: periudha e kontributeve mbi 10 vjet dhe grup moshë mbi 55 vjeç për gratë dhe mbi 60 vjeç për burrat. Vërehet gjithashtu se, këto dy grup-moshë, vazhdojnë të zënë dhe numrin më të madh të përfituesve të së ardhurës nga papunësia në total.

Gjatë muajit shkurt 2022, u miratua VKM-ja Nr.71 "Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës së përfitimit nga punonjësit dhe ish-punonjësit e rafinerisë së naftës, Ballsh". Ky vendim, përcaktonte përfitimin nga kategoria në fjalë, të 100% të vlerës së pagës minimale, si edhe pagesën e kontributeve shoqërore dhe shëndetësore.

Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, gjatë periudhës shkurt-mars 2023, u regjistruan në zyrat e punësimit Mallakastër, Fier, Berat, Vlorë dhe Tiranë, rreth 450 persona aplikantë. Prej totalit të aplikuesve, rreth 435 punëkërkuar të papunë, rezultuan përfitues.

AKPA në fund të vitit 2022, draftoi VKM-në Nr. 646, datë 5.10.2022 "Për procedurat, kriteret dhe rregullat për zbatimin e programeve të formimit profesional nëpërmjet mbështetjes financiare të ofruar, sipas procedurave të konkurrimit, për kurset e formimit profesional të organizuara nga institucionet e formimit profesional, publike apo private". Nëpërmjet kësaj VKM-je, synohet ofrimi i kurseve të avancuara që përputhen me prioritetet e zhvillimit ekonomik. Prioritet ka qenë ofrimi i kurseve të fushës IT, si: kodim, programim, siguri kibernetike, robotikë etj., kundrejt mbështetjes buxhetore për punëkërkuar në masën 50% të vlerës dhe për punëkërkuar të papunë në masën 100 % të vlerës.

Nga auditimi, nuk rezultoi të jenë zhvilluar kurse të trajnimit profesional në zonat rurale e për rrjedhojë, nuk evidentohen gra nga këto zona, të cilat kanë ndjekur kurse të trajnimit profesional. AKPA disponon të dhëna për kursantët, të cilët kanë ndjekur kurset e formimit profesional sipas njësive bashkiake ku ata banojnë. Qendrat e Formimit Profesional janë të lokalizuara në qytetet kryesore, ato në bazë të kërkesave apo nevojave specifike, në disa raste, kanë hapur kurse edhe në bashkitë më të vogla në bashkëpunim me Shkollat e Mesme Profesionale apo bizneset.

Për rajonin verilindor, kurset e formimit profesional ofrohen nga Qendra e Formimit Profesional Lëvizëse, e cila ofron kurse në disa njësi vendore të këtij rajoni.

AKPA, me kërkesë të grupit të auditimit, arriti të nxjerrë të dhëna me bazë gjinore (gra/burra) për të gjitha njësitë administrative, vetëm për tremujorin e IV 2023.

Regjistri i Pu.Pa sipas gjinisë, nëntor 2023

Zonat rurale								Zonat urbane							
Qarku	Bashkia	Total	Femra	Meshkuj	% femra ndaj totalit	femra kryefamiljare	% e femrave kryefam. ndaj totalit	Total	Femra	Meshkuj	femra kryefamiljare	% femra ndaj totalit	% e femrave kryefam. ndaj totalit	femra gjithsej	% e femrave rurale ndaj urbane
Berat	Berat	814	402	412	49.4	112.0	13.8	151	76	75	15	50.3	9.9	478	15.9
Dibra	Dibër	1,557	822	735	52.8	75.0	4.8	301	177	124	14	58.8	4.7	999	17.7
Durrës	Krujë	483	241	242	49.9	29.0	6.0	1,501	815	686	123	54.3	8.2	1,056	77.2
Elbasan	Elbasan	2,230	1,290	940	57.8	242.0	10.9.	336	208	128	31	61.9	9.2	1,498	13.9
Fier	Lushnjë	1,388	776	612	55.9	141.0	10.2	800	455	345	53	56.9	6.6	1,231	37.0
Gjirokastrë	Gjirokastrë	1,422	705	717	49.6	114.0	8.0	391	208	183	19	53.2	4.9	913	22.8
Korçë	Pogradec	1,358	725	633	53.4	137.0	10.1	609	312	297	43	51.2	7.1	1,037	30.1
Lezhë	Lezhë	586	360	226	61.4	91.0	15.5	609	369	240	60	60.6	9.9	729	50.6
Shkodër	Shkodër	1,938	994	944	51.3	143.0	7.4	639	372	267	34	58.2	5.3	1,366	27.2
Tiranë	Kavajë	1,302	715	587	54.9	146.0	11.2	632	362	270	47	57.3	7.4	1,077	33.6
Vlorë	Vlorë	2,161	1,235	926	57.1	261.0	12.1.	81	51	30	11	63.0	13.6	1,286	4.0
Kukës	Kukës	3,828	1,961	1,867	51.2	219.0	5.7	352	217	135	20	61.6	5.7	2,178	10.0
Fier	Divjakë	131	67	64	51.1	8.0	6.1	578	319	259	46	55.2	8.0	386	82.6
	Total	19,198	10,293	8,905	53.6	1,718.0	8.9	6,980	3,941	3,039	516	56.5	7.4	14,234	27.7

Burimi: AKPA / Punoi grupi i auditimit

Nga analizimi i të dhënave të mësipërme, vëmë re se Pu.Pa të regjistruar, janë më shumë në zonat rurale sesa në zonat urbane. Përfundimisht bën vetëm bashkia Krujë, ku Pu.Pa, janë më të shumtë në zonën urbane.

Papunësia kaq e lartë e regjistruar në zonat rurale, tregon qartë se sfidat me të cilat përballet gruaja shqiptare në zonat rurale, si: lufta kundër stereotipeve gjinore, pabarazia gjinore, parandalimi i të gjitha formave të dhunës ndaj tyre, aksesit në shërbimet shëndetësore dhe sociale etj., fillimisht duhet të evidentohen dhe më pas të luftohen. Nëse duam të konsiderojmë një zhvillim të qëndrueshëm të vendit, përmirësimi dhe ndryshimi i këtyre sfidave apo edhe shtimi i të gjitha burimeve për të realizuar fuqizimin ekonomik të grave, duhet të konceptohet që nuk është vetëm për to, por nëpërmjet rritjes së saj, gratë fuqizojnë të ardhurat ekonomike të familjeve të tyre dhe japin një kontribut për të gjithë zhvillimin e vendit.

Në bazë të analizave vjetore për vitet 2019–2022 dhe Raportimeve sipas prioriteteve strategjike, rezultateve të pritshme (nënobjektivave) dhe aktiviteteve të kryera nga AKPA, programet e nxitjes së punësimit mund të quhen të suksesshme për sa i përket aspektit gjinor, kjo edhe për faktin se prej tyre, ka një rritje të % së përfituesve femra, krahasuar me përfituesit meshkuj por, rezulton se pavarësisht kësaj, akoma ka një hendek gjinor në punësim, i cili nuk është arritur të barazohet. Referuar të dhënave zyrtare mbi punësimin dhe papunësinë në vend, vëmë re se nuk ka një analizim të të dhënave në bazë të ndarjes së zonave në rurale dhe urbane. Gjithashtu, vlen për t'u theksuar se, një numër i konsiderueshëm i shtetasve shqiptarë, janë larguar jashtë vendit vitet e fundit. Sipas INSTAT¹³, Popullsia e Shqipërisë më 1 janar 2023 rezulton 2.761.785 banorë, duke pësuar një rënie me 1,1 %, krahasuar me 1 janar 2022. Numri i imigrantëve në vitin 2022 ishte 13.963 persona: 51,9 % më shumë, krahasuar me një vit më parë. Numri i emigrantëve ishte 46.460 persona: 10,5 % më shumë, krahasuar me vitin 2021. Migracioni neto (diferenca midis imigrantëve dhe emigrantëve), ka shënuar një përmirësim të lehtë, krahasuar me një vit më parë: nga -32.853 në -32.497 banorë në vitin 2022. Sipas shifrave të fundit, fluksi i largimit ka qenë shqetësues gjatë periudhës 2018–2023, duke shënuar ulje të ndjeshme dhe duke ndikuar në popullsinë e shumicës së qarqeve në vend (pa analizuar këtu të larguarit për arsye azili dhe "Lotari Amerikane", ku shqiptarët renditen të parët në Evropë për numrin më të lartë të aplikantëve). Pjesa më e madhe e të larguarve janë meshkuj ku, pjesa dërrmuese e të cilëve, janë të aftë për punë. Gjithashtu, këto largime ndikojnë drejtpërdrejt në jetën e grave dhe vajzave në zonat rurale, duke i ngarkuar ato edhe më shumë me impenjimet që kërkon jeta në këto zona. Një tjetër faktor i cili është shumë i rëndësishëm për sa i përket analizës së nivelit të punësimit, është edhe informaliteti i tregut të punës. Për këtë arsye, punësimi duhet të shihet në mënyrë të integruar me emigracionin, informalitetin dhe me nevojat e zonave rurale.

Bazuar në udhëzimin nr. 25, datë 16.06.2020, i cili përcakton metodologjinë e shpërndarjes së fondeve të programeve të nxitjes së punësimit mbi kritere të përcaktuara (si nr. i Punëdhënësve të regjistruar, nr. i Punëkërkuësve të Papunë të regjistruar, treguesit e monitorueshëm për çdo rajon dhe zyrë etj.), AKPA vijoi me planifikimin dhe zbatimin e programeve. Shpërndarja e Fondit dhe Pjesëmarrësve në Programet e Nxitjes së Punësimit për vitin 2022, u miratua me shkresën Nr. 485/1 datë 06.04.2022 "Dërgohet tabela e fondeve të nxitjes së punësimit", në Buletinin e Njoftimeve Publike të Agjencisë së Prokurimit Publik Nr. 50, datë 19.04.2022.

Në rastet e përcaktimit të indikatorëve konkretë në strategjitë përkatëse të grupeve të veçanta, AKPA i përfshin ato në nivel indikatorësh në procesin e planifikimit dhe në Kartën e Performancës. Sa më sipër, rezulton se ka pasur një shpërndarje pozitive të fondeve dhe realizimeve për sa i përket aspektit gjinor, pasi në fund të vitit 2022, nga numri total i përfituesve prej 4344 individësh (përfshirë të mbarturit), 2573 janë gra/vajza ose 59 % e totalit. Por, nga kjo shpërndarje nuk evidentohet se sa nga këto gra dhe vajza janë në zonat rurale.

13. Popullsia e Shqipërisë, 1 janar 2023

Zbatimi i planit të shërbimeve në zonat e pambuluara.

Më datë 17.12.2018, midis Shërbimit Kombëtar të Punësimit dhe ADISA-s, është nënshkruar një marrëveshje bashkëpunimi, e cila synonte rregullimin dhe legjitimimin e bashkëpunimit reciprok në përmbushje të detyrimeve ligjore të ndërsjella në ofrimin e shërbimeve të sportelit të SHKP-së (sot AKPA) sipas shtojcës I, nga sportelet e ADISA-s, sipas parimit të ndarjes së Zyrave Pritëse nga Zyrat Përgjegjëse për shërbimin. Gjithashtu, gjatë vitit 2019, ish-SHKP (aktualisht AKPA), ka ndërmarrë nismën për nënshkrimin e marrëveshjeve me Njësitë e Qeverisjes Vendore në kuadër të forcimit dhe bashkërendimit të politikave të punësimit në nivel rajonal dhe vendor. Me qëllim arritjen e kohezionit territorial të shërbimeve të punësimit, është rishikuar dhe dërguar për miratim struktura e Drejtorive Rajonale të Punësimit, në të cilën janë parashikuar punonjës shtesë për mbulimin e programeve të reja, si ai i garancisë rinore dhe fondit social në rajonet që është vlerësuar e nevojshme, duke u nisur kryesisht nga numri i punëkërkuësve të papunë.

Për rezultatin e strategjisë C2.1 Hartimi i skemës riintegruese në tregun e punës të përfituesve të skemës së Ndhmës Ekonomike.

AKPA, gjatë intervistimit dhe vlerësimit të punëkërkuësit të papunë nga këshilluesi, mund të evidentojë se Pu.Pa (zakonisht grupet vulnerabël si NE dhe grupe të tjera), nuk mund të punësohet për shkak të ekzistencës së disa pengesave të tjera, të cilat mund të zgjidhen prej bashkive dhe institucioneve të tjera. Në raste të tilla, Pu.Pa merr statusin pezull dhe referohet në institucionin apo OJF-në përkatëse. Sikurse përmendet edhe në indikatorin 1.5, me qëllim rregullimin e sistemit të referimit, AKPA në bashkëpunim me UNDP, ka hartuar një Udhëzues për menaxhimin e integruar të rastit ZP dhe NJVNR.

Bashkëpunimi për riintegrimin në tregun e punës të kategorisë NE dhe ish-NE

Marrëveshja midis AKPA-s dhe Shërbimit Social Shtetëror të nënshkruar për riintegrimin në tregun e punës të përfituesve aktualë dhe ish-përfituesve të ndihmës në para, dha si rezultat:

Për vitin 2019:

- Punësimin e 1,168 përfituesve të mëparshëm dhe 1,875 përfituesve;
- Pjesëmarrjen e 403 përfituesve të mëparshëm dhe 311 përfituesve në programe aktive të tregut të punës;
- Pjesëmarrjen e 92 përfituesve të mëparshëm dhe 361 përfituesve në kurse të formimit profesional.

Për vitin 2020:

- Punësimin e 455 përfituesve të mëparshëm dhe 1,374 përfituesve;
- Pjesëmarrjen e 62 përfituesve të mëparshëm dhe 165 përfituesve në programe aktive të tregut të punës;
- Pjesëmarrjen e 43 përfituesve të mëparshëm dhe 170 përfituesve në kurse të formimit profesional.

Për vitin 2021:

- Punësimin e 185 përfituesve të mëparshëm dhe 972 përfituesve;
- Pjesëmarrjen e 59 përfituesve të mëparshëm dhe 326 përfituesve në programe aktive të tregut të punës;
- Pjesëmarrjen e 15 përfituesve të mëparshëm dhe 433 përfituesve në kurse të formimit profesional.

Gjatë vitit 2022, pati prioritet riintegrimi në tregun e punës të përfituesve të Ndhmës Ekonomike. Për këtë arsye në mbështetje të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 822, datë 24.12.2019 “Për mekanizmin e bashkërendimit ndërinstitucional të punës për referimin për punësim të individëve dhe anëtarëve në moshë aktive pune të familjeve përfituese të NE”, u hartua dhe nënshkrua Urdhri i Përbashkët midis Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë dhe Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale. U ngritën komisione rajonale, të cilët vlerësuan dhe referuan për punësim dhe integrim social anëtarët në moshë aktive pune. Këto komisione kishin përfaqësues nga Shërbimi Social Shtetëror, Drejtoritë Rajonale të Punësimit dhe Drejtoritë e Shërbimeve Sociale në Bashki. Pranë Zyrave të Punësimit u referuan nga SHSSH 16.529 skeda. Ndërkohë, u paraqitën pranë zyrave të punësimit 10.840 persona apo 65% e personave të referuar në total.

1 në 3 persona të paraqitur, janë ndërmjetësuar për punësim dhe janë referuar për pjesëmarrje në program nxitje punësimi apo në formim profesional. Konkretisht, janë punësuar dhe kanë marrë pjesë në programet e nxitjes së punësimit 2.328 punëkërkues të papunë dhe 813 të tjerë kanë filluar një kurs të formimit profesional.

Projekte të dedikuara për shtrirjen e shërbimeve në zona të pambuluara

AKPA në bashkëpunim me Expertise France, kanë dizenuar dhe validuar një paketë gjithëpërfshirëse shërbimesh dhe programesh punësimi, të përshtatura për gratë që banojnë në zonat rurale dhe zona të tjera që aktualisht nuk mbulohen plotësisht nga shërbimet publike të punësimit. Në zbatimin pilot të kësaj pakete, do të përfshihen tre bashki: Elbasani, Lushnja dhe Kamza. Zhvillimi i kësaj pakete të validuar të shërbimeve të punësimit për gratë e papuna që jetojnë në zona rurale dhe zona të tjera që aktualisht nuk mbulohen nga shërbimet e punësimit, bazohet në një dokument koncept të mëparshëm të qarkulluar në muajin prill 2023, dhe më pas, në seminarin e prezantimit dhe validimit të kësaj pakete shërbimesh punësimi të mbajtur në qershor 2023, si dhe në një studim të mëparshëm analitik mbi rrethanat dhe nevojat e veçanta të grupit të synuar, të cilat janë gratë që jetojnë në zona rurale dhe/ose në zona të tjera që aktualisht nuk mbulohen nga Shërbimet Publike të Punësimit. Dokumenti aktual pasqyron rezultatet e seminarit të prezantimit dhe vlerësimit, diskutimet e detajuara të zhvilluara me MFE, AKPA në nivel qendror dhe lokal, stafin e Shërbimit Social në tre Bashkitë pilot të propozuara, OJF, partnerë të ndryshëm, etj.

Metodologjia e përdorur në hartimin e Paketës së Shërbimeve të Punësimit

Metodologjia bazohet në hartimin e një modeli praktik operacional për zbatimin e një pakete të zgjeruar të Shërbimeve të Punësimit për grupin e synuar. Grupi i synuar, nga një këndvështrim operacional, mund të përshkruhet si gra që banojnë në njësitë administrative, të cilave u mungojnë strukturat



2,328

PUNËKËRKUES TË PAPUNË

janë punësuar dhe kanë marrë pjesë në programet e nxitjes së punësimit **813 të tjerë kanë filluar një kurs të formimit profesional.**

vendore të Shërbimeve të Punësimit të AKPA-s ose ndodhen shumë larg çdo pike shërbimi ekzistuese të AKPA-s. Modeli operacional i propozuar për zbatimin e një pakete të zgjeruar të Shërbimeve të Punësimit për grupin e synuar, do të arrihet duke shfrytëzuar instrumentin ekzistues të AKPA-s dhe duke zhvilluar tregues të performancës në lidhje me ofrimin e shërbimeve për grupin e synuar. Kjo iniciativë, po pilotohet në kushtet kur midis viteve 2019–2021, paketa e AKPA-s e Programeve Aktive të Tregut të Punës (PATP-ve), është përditësuar dhe janë bërë shtesa. Në këtë proces, modeli i udhëzimit dhe këshillimit të planifikimit me katër faza, është prezantuar dhe integruar në sistemin e ri të shërbimeve të punësimit. Profilizimi ekonometrik është përfshirë gjithashtu në sistemin e menaxhimit të rasteve, për herë të parë në AKPA në Shqipëri. Këto karakteristika mundësojnë identifikimin e atyre punëkërkesve që kanë më shumë nevojë për shërbime intensive punësimi dhe të atyre që janë më larg nga tregu i punës.

Programi i ri i nxitjes së punësimit, i hartuar

Projektvendimi “Për procedurat, kriteret dhe rregullat për zbatimin e programeve të nxitjes së punësimit nëpërmjet riintegritimit social”, ka për qëllim rregullimin e përcaktimit të kriterëve, të procedurave për programin e nxitjes së punësimit nëpërmjet ofrimit të këshillimit të specializuar për punësim, vetëpunësim ose formim profesional, koordinimin dhe referimin në shërbimet e punësimit dhe shërbimet sociale, të cilat ndihmojnë përfituesit të integrohen në tregun e punës.

Programi i Trajnimit për Aftësitë Bazë, synon të targetojë punëkërkesit e papunë të regjistruar pranë Zyrave të Punës me fokus përfituesit e skemës së ndihmës ekonomike dhe gratë që banojnë në njësitë administrative/vendore, ku nuk ka struktura vendore punësimi.

Target-grupi i synuar, ka nevojë për shërbime të këshillimit të specializuar, nisur nga kompleksiteti i vulnerabilitetit që paraqet dhe për të siguruar mbulimin me shërbime dhe programe punësimi në zonat ku nuk ka struktura vendore punësimi.

Programi i riintegritimit social, u ofron përfituesve shërbimet mbështetëse si edhe një mbështetje financiare për pjesëmarrjen në program, të tilla si: Pagesë për pjesëmarrje, bonuse për shpenzime të transportit, për kujdesin e fëmijës dhe/ose të moshuarve ose personave të sëmurë në ngarkim.

Efektet e pritshme të programit, synojnë të jenë ofrimi i këshillimit të specializuar dhe dedikuar për punësim, vetëpunësim ose formim profesional të pjesëmarrësve të programit, në bazë të Planit Individual të Riintegritimit dhe Punësimit. Gjithashtu, programi angazhohet në integrimin e qëndrueshëm të tyre në tregun e punës, jo vetëm nëpërmjet këtyre shërbimeve, por edhe nëpërmjet bonuseve të parashikuara për t’u ofruar në rast punësimi të pjesëmarrësit deri në një afat maksimal prej 6 (gjashtë) muajsh pa shkëputje pas përfundimit të programit.

OJF-të janë të dedikuara dhe specializuara në trajtimin e grupeve vulnerabël dhe kjo do të ndihmojë në trajtimin e specializuar të tyre dhe reduktimin e fluksit të punëkërkesve të papunë që marrin shërbime pranë Zyrave të Punës.

Gjithashtu, synohet që OJF-të të shtrijnë veprimtarinë edhe në zona të pambuluara nga Zyrat e Punës, duke ofruar shërbimin e këshillimit për të gjithë personat që jetojnë në zona rurale apo zona të vështira për të aksesuar shërbimet.



Gjetje:

1. Gjetje nga auditimi:

Programet e nxitjes së punësimit të zbatuara nga AKPA për vitet 2020–2023, janë të përgjithshme, nuk kanë në fokus gratë dhe, në veçanti, gratë në zonat rurale. Këto programe parashikohet të zbatohen në të gjithë vendin dhe fokusohen te grupet vulnerabël, por nuk evidentohet se sa janë të zbatueshme në zonat rurale.

- Indikatorët e përdorur, nuk ndahen në gra në fshat apo gra në qytet, por të dhënat e referuara dhe analizimi i tyre, është për gratë në përgjithësi. Po ashtu, edhe të dhënat e tjera (si p.sh., për nivelin e arsimimit, grup-mosha), të cilat administrohen nga AKPA kufizohen vetëm në nivel kombëtar dhe nuk ka klasifikime në rang urban dhe rural.

2. Gjetje nga auditimi:

AKPA, për të gjykuar efektivitetin e programeve aktuale të miratuara, nuk ka matur dhe analizuar nivelin e rezultateve të punësimit nga këto programe për gratë në zonat rurale. Aktualisht AKPA, nëpërmjet strukturave të saj, ka kryer gjurmim të rezultateve për programet e përfituara nga punëkërkesit e papunë vetëm për vitin 2020. Sipas përcaktimeve të rregulloreve të zbatimit të programeve, ky proces duhej të realizohej 6 muaj mbas përfundimit të tyre.

3. Gjetje nga auditimi:

Vlerësimi i nevojave të grupeve të veçanta për mbështetje nëpërmjet PATP-ve, nuk është bërë gjithmonë në bashkëpunim me Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore. Konkretisht, AKPA ka bërë hartimin dhe diversifikimin e PATP-ve, duke u bazuar vetëm në databazën e të dhënave që ka në dispozicion, por studimi i databazës, nuk jep panoramën e gjithë rajoneve. Po kështu, edhe NJVQV-të që kanë bërë një analizë më të gjerë të nevojave faktike të grave me qëllim fuqizimin e tyre, si në rastin e Dibrës, nuk i kanë adresuar këto nevoja në AKPA. Për rrjedhojë të kësaj situate, nuk ka pasur raporte të vlerësimit të nevojave për shërbime të punësimit dhe të formimit në zona të pambuluara.

4. Gjetje nga auditimi:

Nga auditimi nuk rezultoi të jenë zhvilluar kurse të trajnimit profesional në zonat rurale e, për rrjedhojë, nuk u evidentuan gra nga këto zona, të cilat të kenë ndjekur kurse të trajnimit profesional. Vetë AKPA, disponon të dhëna për kursantët që kanë ndjekur kurset e formimit profesional sipas njësive bashkiake ku ata banojnë, kjo pasi Qendrat e Formimit Profesional janë të lokalizuara në qytetet kryesore, por këto të dhëna nuk janë të disagreguara sipas prejardhjes urbane-rurale.



Konkluzione:

1. Programet e nxitjes së punësimit të realizuara nga AKPA gjatë viteve 2019-2023, janë të përgjithshme dhe jo të ndara në bazë gjinore, aq më pak me fokus të qartë për gratë në zonat rurale.
2. Të dhënat lidhur me programet e nxitjes së punësimit, nuk flasin për gratë rurale. Aksesit i grave në tregun e punës dhe punësimi i denjë për to, janë elemente shumë të rëndësishëm në mbështetje të fuqizimit ekonomik.
3. Mungojnë dokumentet e politikave qeveritare që të kenë si grup të synuar gratë që jetojnë në zona rurale, apo që të trajtojnë vështirësitë me të cilat përballen gratë që jetojnë në zona rurale në lidhje me punësimin, varfërinë dhe aksesin në shërbime shëndetësore, arsim, infrastrukturë, sigurime shoqërore, etj.
4. Mungesa e treguesve të matshëm sasiorë ose cilësorë gjinorë në realizimin e programeve dhe kartën e performancës, të nevojshëm për të monitoruar ecurinë e rezultateve të arritura dhe përmbushjen e qëllimeve specifike, kontribuon në mungesën e efikasitetit dhe efektivitetit të programeve të administruara nga AKPA, duke ndikuar në efektivitetin e zbatimit të këtyre programeve për fuqizimin e grave në zonat rurale.
5. Gjithashtu, ka munguar një koordinim efektiv ndërmjet DRAKPA-ve dhe DRFPP-ve në rajone, për sa i përket hartimit dhe analizimit të nevojave të punësimit të grave në zonat rurale.



Rekomandime:

1.1 Rekomandim:

Agjencia Kombëtare për Punësimin dhe Aftësim, të përqendrohet edhe te nevojat reale të grave në zonat rurale në lidhje me shërbimet e programeve të nxitjes së punësimit, shërbimet e trajnimit dhe sistemet e informacionit mbi tregun. [Në vijimësi](#)

2.1 Rekomandim:

Agjencia Kombëtare për Punësimin dhe Aftësim, të grumbullojë dhe të analizojë të dhënat mbi realizimin e programeve të nxitjes së punësimit, duke i ndarë në bazë të zonave administrative urbane-rurale, si dhe duke shtuar e përfshirë në analizimin e të dhënave edhe kategorinë "gra në zonat rurale". [Në vijimësi](#)

3.1 Rekomandim:

Agjencia Kombëtare për Punësimin dhe Aftësim, t'i propozojë Ministrisë së Financave për pjesën e mbetur të zbatimit të programeve të nxitjes së punësimit, prioritetet sipas zonave gjeografike, sektorëve ekonomikë dhe nevojave të punëkërkueseve gra në zonat rurale, si dhe të hartojë programe konkrete punësimi për përfshirjen e tyre në tregun e punës. [Në vijimësi](#)

4.1 Rekomandim:

Agjencia Kombëtare për Punësimin dhe Aftësim, në bashkëpunim me njësitë e vetëqeverisjes vendore, të mundësojnë hapjen e kurseve profesionale për gratë e vajzat në zonat rurale, të përcaktuara në bazë të prioritetëve dhe zhvillimit të secilës zonës rurale. [Brenda vitit 2024](#)

5.2 A janë marrë masa konkrete që nxisin përfshirjen e grave rurale në tregun e punës?

Strategjia Kombëtare për Barazinë Gjinore (SKBGJ) 2016–2020¹⁴ dhe Plani i saj i Veprimit, hartuar nga Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë me kontributin e Grupit Ndërinstitucional të Punës¹⁵, është konceptuar si një udhërrëfyes drejt një shoqërie të mundësive të barabarta e pa dhunë, në të cilën: nevojat e grave dhe burrave merren në konsideratë dhe trajtohen në mënyrë të barabartë; gratë respektohen, mbrohen, nxiten e mbështeten për të ecur përpara njëllor si dhe burrat; vajzat e djemtë, rriten të lumtur e të gëzuar mes parimeve të barazisë e mosdiskriminimit; pra një shoqëri, që ka në bazë një familje të shëndoshë, komunitet mbështetës dhe institucione të konsoliduara, që zbatojnë legjislacionin dhe detyrimet e tyre me përgjegjshmëri. Referuar kësaj strategjie, një nga nënobjektivat tregues për fuqizimin e grave në zonat rurale, është dhe nënobjektivi “1.3.14. Ofrimi i çerdheve dhe kopshteve në zonat rurale”, i cili ka si institucione zbatuese njësitë e qeverisjes vendore, të cilat duhet të raportojnë në nivel qendror për realizimin e tij. Buxheti i vënë në dispozicion për realizimin e këtij objektivi sipas kësaj strategjie për periudhën 2017–2020, është 80,000,000.00 lekë, për periudhën 2019–2020 është 24,000,000.00 lekë çdo vit, për periudhën 2017–2016 është 16,000,000.00 lekë çdo vit.

Grupi i auditimit ka vlerësuar me anë të pyetësorëve të posaçëm, se çfarë masash kanë marrë Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore objekt i këtij auditimi në:

- Zvogëlimin e barrierave që i mbajnë gratë, të rejat dhe vajzat larg tregut të punës.
- Ndërtimin, rehabilitimin dhe mirëmbajtjen e rrugëve vendore (ofrimi i transportit publik të rregullt në të gjitha Njësitë Administrative);
- Ndërtimin, rehabilitimin dhe mirëmbajtjen e ndërtesave arsimore të sistemit arsimor parashkollor në kopshte dhe çerdhe.

Nga të dhënat zyrtare të siguruara nga 12 prej 13 njësive të qeverisjes vendore, ato ndryshojnë sipas shpërndarjes demografike të tyre dhe janë si më poshtë vijon:

Bashkia Shkodër

Të dhëna mbi numrin e kopshteve dhe çerdheve në Bashkinë Shkodër 2019–2023

Njësia Admis.	Urbane	Rurale	Çerdhe	Kopshte	Ofrohet transport publik	Nr. banorësh 2019	Nr. banorësh 2020	Nr. banorësh 2021	Nr. banorësh 2022	Nr. banorësh 2023
Qytet	X		PO	PO	PO	115,215	111,514	115,401	115,765	116,593
Rrethina		X	JO	PO	PO	26,399	27,014	27,927	28,448	29,115
Postribë		X	JO	PO	PO	11,666	11,716	11,691	11,705	11,829
Gur i Zi		X	JO	PO	PO	12,003	12,096	12,172	12,666	12,264
Velipojë		X	JO	PO	PO	9,715	9,778	9,857	9,922	10,065
Dajç		X	JO	PO	PO	9,047	9,077	9,085	9,098	9,142
Ana e Malit		X	JO	PO	PO	6,094	6,109	6,119	6,130	6,157
Bërdicë		X	JO	PO	PO	9,811	9,859	9,917	10,017	10,215
Pult		X	JO	JO		3,064	3,043	2,941	2,919	2,956
Shosh/Shalë		X	JO	JO		5,600	5,336	5,072	4,947	4,881
Shalë		X	JO	JO	PO					
TOTAL						208,614	209,542	210,182	211,117	213,217

Burimi: Bashkia Shkodër, përpunoi grupi i auditimit

14. Këtu e në vijim SKBGJ 2016–2020.

15. Sipas Urdhrit të Kryeministrit nr. 15, datë 21.01.2016 “Për ngritjen dhe funksionimin e grupit ndërinstitucional të punës për hartimin e dokumentit strategjik për çështjet e barazisë gjinore 2016–2020”.

Referuar të dhënave të grumbulluara nga Bashkia Shkodër, të përpunuara nga grupi i auditimit dhe të paraqitura në mënyrë të përmbledhur në tabelën më sipër, për 11 njësi administrative ku 1 NjA është urbane dhe 10 NjA janë rurale, rezulton se për periudhën objekt auditimi, vitet 2019–2023:

- Në zonat rurale të Bashkisë Shkodër, nuk kemi çerdhe. Çerdhe ka vetëm në NjA Qytet që është NjA urbane, në 10 njësitë e tjera administrative që janë rurale, nuk ka çerdhe.
- Kopshte ka vetëm në 8 njësi administrative nga 11 njësi administrative që ka Qyteti i Shkodrës në total. Në NjA rurale Pult, Shosh, Shalë nuk ka kopshte.
- Transporti publik sigurohet vetëm në 9 njësi administrative nga 11 në total, ku 1 NjA është urbane dhe 8 janë rurale. Në NjA Pult dhe Shosh, nuk ofrohet transport publik.
- Popullsia për çdo njësi administrative ka ndryshuar, ajo është rritur në qytet, ka ndryshuar në zonat rurale, por numri i çerdheve dhe kopshteve, nuk ka ndryshuar në raport me numrin e banorëve për çdo njësi administrative të Bashkisë Shkodër.

Të dhëna mbi investimet, që janë kryer në kopshtet, çerdhet, infrastrukturën në Bashkinë Shkodër të ndara, sipas njësive administrative rurale / urbane në vlerë financiare, për periudhën 2019–2023.

Njësia Administrative rurale /urbane	Çerdhe Investim 2019–2022	KopshtInvestim 2019–2021
Qytet (urbane)	JO	3,898,530 ¹⁶
Rrethina (rurale)	JO	2,358,990 ¹⁷
Postripë (rurale)	JO	JO
Gur i zi (rurale)	JO	JO
Velipojë (rurale)	JO	JO
Dajç (rurale)	JO	JO
Ana e Malit (rurale)	JO	2,967,120 ¹⁸
Bërdicë (rurale)	JO	JO
Pult (rurale)	JO	JO
Shosh (rurale)	JO	JO
Shalë (rurale)	JO	JO

Burimi: Bashkia Shkodër, përpunoi grupi i auditimit

Referuar të dhënave të paraqitura nga Bashkia Shkodër, konstatohet se për periudhën 2019–2022, janë bërë 4 investime vetëm për kopshte, konkretisht: 2 investime në 2 zona rurale dhe 2 investime në 2 zona urbane, në vlerën totale prej 9,224,640 lekësh. Gjatë vitit 2023, nuk janë kryer investime në kopshte apo në çerdhe.

16. Investim i vitit 2021–2022

17. Investim i vitit 2020

18.. Investim i vitit 2019

Bashkia Kukës

Të dhëna mbi numrin e kopshteve dhe çerdheve në Bashkinë Kukës 2019–2023

Njësia Administrative	Urbane	Rurale	Çerdhe	Kopshte	Ofrohet transport publik
Kukës /Qytet	X		Po	Po	Jo
Shtiqen		X	Jo	Po	Jo
Tërthorë		X	Jo	Po	Jo
Bicaj		X	Jo	Po	Po
TopoJan		X	Jo	Po	Jo
Shishtavec		X	Jo	Po	Jo
Zapod		X	Jo	Po	Jo
Ujmisht		X	Jo	Po	Jo
Grykë Çaj		X	Jo	Po	Jo
Kolsh		X	Jo	Po	Jo
Malzi		X	Jo	Po	Po
Surroj		X	Jo	Po	Jo
Bushtricë		X	Jo	Po	Po
Kalis		X	Jo	Po	Jo
Arren		X	Jo	Jo	Jo

Burimi: Bashkia Kukës, përpunoi grupi i auditimit

Bashkia Kukës ka 15 njësi administrative, ndër të cilat 1 njësi urbane dhe 14 njësi rurale.

Në 14 njësi rurale të Bashkisë Kukës nuk ka çerdhe, ndërsa kopshte ka vetëm në 14 njësi administrative nga 15 Njësi Administrative që ka qyteti i Kukësit në total. Sa i përket transportit publik, ai sigurohet vetëm në 3 njësi administrative rurale.

Sa i përket të dhënave në lidhje me investimet në kopshte e çerdhe të ndara sipas NjA rurale/urbane për vitet 2019–2023, nga Bashkia Kukës nuk është kryer një ndarje në të dhëna në formë kronologjike sipas periudhës objekt auditimi. Investimet për ndërtimin e kopshteve dhe çerdheve në Bashkinë Kukës, i referohen: Rikonstruksioni i godinës së Kopshtit Nr. 2 Lagjja Nr. 3 dhe Rehabilitimi i oborrit dhe këndit të lojërave për Kopshtin Nr. 2, Lagjja Nr. 3, në vlerën totale prej 9,636,446 lekësh. Këto investime nuk përcaktohen se cilës periudhe dhe njësie administrative të Bashkisë Kukës, i përkasin.

Bashkia Lezhë

Të dhëna mbi numrin e kopshteve dhe çerdheve në Bashkinë Lezhë 2019–2023

Njësia Admis.	Urbane	Rurale	Çerdhe	Kopshte	Ofrohet transport publik	Nr. banorësh 2019	Nr. banorësh 2020	Nr. banorësh 2021	Nr. banorësh 2022	Nr. banorësh 2023
Balldre				PO (6)	PO (6)	10,997	10,997	11,103	11,031	11,032
Blinisht		X		PO (5)	PO (5)	5,776	5,776	5,806	5,847	5,858
Dajç		X		PO (6)	PO (6)	7,350	7,350	7,407	7,524	7,625
Kallmet		X		PO (4)	PO (3)	7,379	7,379	7,428	7,520	7,520
Kolsh		X		PO (4)	PO (4)	7,349	7,349	7876	7,920	8,039
Lezha	X		YES (1)	PO (4)	PO (4)	31,799	31,799	32,136	32,668	33,413
Shëngjin		X		PO (4)	PO (3)	12,966	12,966	13,528	13,740	13,950
Shënkoll		X		PO (4)	PO (4)	17,372	17,372	17,515	17,802	17,973
Ungrej		X		JO (0)	PO (1)	2,853	2,853	2,689	2,600	2,583
Zejmen		X		PO (5)	PO (5)	9,714	9,714	9,622	9,460	9,443
Total	1	9	1	42	41	113,555	113,555	115,110	116,112	117,436

Burimi: Bashkia Lezhë, përpunoi grupi i auditimit

Referuar të dhënave të paraqitura nga Bashkia Lezhë, konstatohet se për çdo vit auditimi, popullsia për çdo njësi administrative ka ndryshuar, ajo është rritur në qytet, ka ndryshuar në zonat rurale, por çerdhet dhe kopshtet nuk kanë ndryshuar në numër në raport me numrin e banorëve për çdo njësi administrative urbane/rurale. Në zonat rurale të Bashkisë Lezhë, nuk kemi çerdhe, por vetëm 1 çerdhe në njësinë administrative urbane Lezhë. Kopshte ka në 10 njësi administrative në total që ka qyteti i Lezhës, nga të cilat 1 urbane dhe 9 rurale. Sa i përket të dhënave në lidhje me investimet në kopshte e çerdhe të ndara sipas NjA rurale/urbane për vitet 2019– 2023, nga Bashkia Lezhë janë kryer 3 investime në kopshte dhe 1 investim në çerdhe, konkretisht: Viti 2019, Investim në ndërtim kopshti në 1 njësi rurale në vlerën 80,221,200 lekë, Viti 2021, Investim në ndërtim kopshtesh në 2 njësi rurale në vlerat 6,605,672 lekë dhe 3,021,288 lekë, Viti 2022, Investim në ndërtim çerdhe në 1 njësi rurale në vlerën 29,856,367 lekë. Investimet në çerdhe e kopshte në Bashkinë Lezhë për periudhën objekt auditimi, kanë qenë në vlerën 119,704,527 lekë.

Bashkia Krujë

Të dhëna mbi numrin e kopshteve dhe çerdheve në Bashkinë Krujë 2019–2023

Njësia Administrative	Urbane	Rurale	Çerdhe	Kopshte	Ofrohet transport publik
Krujë	X			PO (7)	PO
Fushë-Krujë	X			PO (6)	PO
Thumanë		X		PO (5)	PO
Nikël		X		PO (6)	
Bubq		X		PO (5)	
Cudhi		X		PO (2)	
Total				2	31

Burimi: Bashkia Krujë

Referuar të dhënave zyrtare nga Bashkia Krujë, konstatohet se për çdo vit objekt auditimi, popullsia për çdo njësi administrative ka ndryshuar dhe ka ardhur në rritje. Bashkia Krujë ka 6 njësi administrative, ndër të cilat 2 njësi urbane dhe 4 rurale. Në 6 njësi administrative të Bashkisë Krujë, ka 2 çerdhe vetëm në njësinë urbane Krujë, ndërsa kopshte ka në të gjitha njësitë administrative që ka qyteti i Krujës. Sa i përket transportit publik, ai sigurohet vetëm në 3 njësi administrative të Bashkisë Krujë. Sa i përket të dhënave në lidhje me investimet në kopshte e çerdhe të ndara sipas NjA rurale/urbane për vitet 2019–2023, nga Bashkia Krujë janë si vijojnë: Për vitin 2019 dhe vitin 2023, nuk ka pasur investime në çerdhe, kopshte apo infrastrukturë në asnjë njësi administrative të Bashkisë Krujë.

Për vitin 2020:

- Është investuar në 4 njësi administrative rurale për rikonstruksion çerdhesh, kopshtesh dhe infrastrukturë në vlerën 1,077,628,282 lekë,

○ Për vitin 2021:

- Është investuar në 4 njësi administrative rurale për rikonstruksion çerdhesh, kopshtesh dhe infrastrukturë në vlerën 889,304,782 lekë,

Për vitin 2022:

- Është investuar në 1 njësi administrative rurale për rikonstruksion çerdhesh, kopshtesh dhe infrastrukturë në vlerën 335,000 lekë.

Bashkia Elbasan

Të dhëna mbi numrin e kopshteve dhe çerdheve në Bashkinë Elbasan 2019–2023

Njësia Administrative	Çerdhe	Kopshte
Bradashesh	0	9
Funar	0	2
Gracen	0	4
Gjergjan	0	5
Gjinar	0	5
Labinot Fushë	0	9
Labinot Mal	0	8
Papër	0	9
Shirgjan	0	6
Shushicë	0	6
Tregan	0	7
Zavalinë	0	1
Lagjja nr.1	0	4
Lagjja nr.2	2	3
Lagjja nr.3	0	3
Lagjja nr.4	1	3
Lagjja nr.5	0	2
Lagjja nr.6	0	1
Total	3	87

Burimi: Bashkia Elbasan, përpunoi grupi i auditimit

Referuar të dhënave të paraqitura nga Bashkia Elbasan me observacionin nr. 54/4, datë 30.01.2024, vënë në dispozicion grupit të auditimit në datë 06.02.2024, kjo bashki ka plotësuar informacionin nga ku konstatohet se për çdo vit objekt auditimi, popullsia për çdo njësi administrative nuk është

përcaktuar. Kjo bashki ka 6 lagje administrative në qytet dhe 12 njësi administrative, të papërcaktuara urbane apo rurale. Në 12 njësi administrative të Bashkisë Elbasan ka 87 kopshte, ndërsa çerdhe ka vetëm në 2 njësi administrative, konkretisht 3 çerdhe. Sa i përket transportit publik, ai sigurohet për këto 18 njësi administrative të Bashkisë Elbasan.

Sa i përket të dhënave në lidhje me investimet në kopshte e çerdhe të ndara sipas NjA rurale/urbane për vitet 2019- 2022, nga Bashkia Elbasan janë si vijojnë:

Tabela për investime për çerdhe dhe kopshte /000Lekë

Njësia Admin.	Viti 2019		Viti 2020		Viti 2021		Viti 2022	
	Çerdhe	Kopshte	Çerdhe	Kopshte	Çerdhe	Kopshte	Çerdhe	Kopshte
AU 1.2...3.4.5.6.....	521	122	345	994	602	1630	410	3545

Burimi: Bashkia Elbasan

Për vitet 2019- 2022, referuar tabelës së mësipërme sjellë zyrtarisht nga Bashkia Elbasan, nuk përcaktohen qartë njësitë administrative ku është investuar në çerdhe apo kopshte.

Për vitin 2023, ka pasur investime në çerdhe, kopshte apo infrastrukturë në zonat urbane dhe rurale në 60 objekte, në vlerën 35,106,960 lekë.

Bashkia Kavajë

Të dhëna mbi numrin e kopshteve dhe çerdheve në Bashkinë Kavajë, viti 2023

Njësia Administrative	Urbane	Rurale	Çerdhe	Kopshte	Nr. banorësh	Ofrohet transport publik
Kavajë	X		JO	JO	40,094	JO
Golem		X	JO	JO	13,929	JO
Synej		X	JO	JO	12,300	JO
Helmas		X	JO	JO	5,202	JO
Luz i vogël		X	JO	JO	11,351	JO
Total					82,876	

Burimi: Bashkia Kavajë, përpunoi grupi i auditimit

Referuar të dhënave të paraqitura nga Bashkia Kavajë, konstatohet se për çdo vit objekt auditimi, popullsia për çdo njësi administrative përgjithësisht ka ndryshuar. Bashkia Kavajë ka 5 njësi administrative, ndër të cilat 1 njësi urbane dhe 4 njësi rurale. Në 5 njësi administrative të Bashkisë Kavajë nuk ka çerdhe, ndërsa kopshte ka vetëm në njësinë administrative urbane Kavajë. Sa i përket transportit publik, ai nuk sigurohet në asnjë njësi administrative të kësaj Bashkie.

Sa i përket të dhënave në lidhje me investimet në kopshte e çerdhe të ndara sipas NjA rurale/urbane për vitet 2019-2022, nga Bashkia Kavajë janë si vijojnë:

Në vitin 2019 ka 1 investim në njësinë administrative urbane Kavajë për rikonstrukcion kopshti në vlerën 39,760,930 lekë,

- Në vitin 2020, ka 2 investime në 2 njësi administrative rurale/urbane në vlerën 404,130,722 lekë,
- Në vitin 2021, ka 2 investime në 2 njësi administrative rurale/urbane në vlerën 404,130,722 lekë,
- Në vitin 2022 nuk ka investime në kopshte e çerdhe,
- Në vitin 2023, ka 3 investime në 3 njësi administrative rurale/urbane në vlerën 371,927,481 lekë.

Bashkia Divjakë

Të dhëna mbi numrin e kopshteve dhe çerdheve në Bashkinë Divjakë 2019-2023

Njësia Admis.	Urbane	Rurale	Çerdhe	Kopshte	Nr. banorësh 2019	Nr. banorësh 2020	Nr. banorësh 2021	Nr. banorësh 2022	Nr. banorësh 2023	Ofrohet transport publik
Divjaka AU	X		Po	Po	14,545	14,651	14,705	14,754	14,761	Po
Terbuf AU		X	Jo	Po	16,671	16,825	16,935	17,043	17,125	Po
Gradisht AU		X	Jo	Po	10,948	11,009	10,996	11,008	11,003	Po
Remas AU		X	Jo	Po	6,776	6,752	6,715	6,756	6,753	Po
Grabian AU		X	Jo	Po	6,535	6,512	6,456	6,442	6,442	Jo
Total					55,475	55,749	55,807	56,003	56,084	

Burimi: Bashkia Divjakë, përpunoi grupi i auditimit

Referuar të dhënave të paraqitura nga Bashkia Divjakë, konstatohet se për çdo vit objekt auditimi, popullsia për çdo njësi administrative përgjithësisht ka ndryshuar, por nuk ka ndryshuar numri i çerdheve dhe kopshteve në raport me numrin e banorëve të çdo njësie administrative të Bashkisë Divjakë. Kjo Bashki ka 5 njësi administrative, ndër të cilat 1 njësi urbane dhe 4 njësi rurale. Në 4 njësi administrative rurale të Bashkisë Divjakë nuk ka çerdhe, ndërsa kopshte ka në çdo njësi administrative. Sa i përket transportit publik, ai sigurohet në 4 njësi administrative rurale/urbane të kësaj Bashkie.

Sa i përket të dhënave në lidhje me investimet në kopshte e çerdhe të ndara sipas NjA rurale/urbane për vitet 2019-2023, nga Bashkia Kavajë janë si vijojnë:

Bashkia Divjakë ka financuar Ndërtimin e Kopshtit në Çermë Proshk, lidhur me kontratën nr. 4686, datë 30.11.2016 në vlerën 4,268,364 lekë, një investim i Bashkisë Divjakë nga fondet e veta.

Bashkia Divjakë ka marrë fonde nga Buxheti i Shtetit në vitin 2019 për ndërtimin e Kopshtit me drekë në Çermë, Sektori Njësia Administrative Tërbuf me një vlerë të plotë financimi prej 50,208,168 lekësh, ku 35,145,718 lekë financohen nga Buxheti i Shtetit dhe 15,062,450 lekë nga Bashkia Divjakë.

Për vitet 2021-2023, nuk ka investime për ndërtim çerdhesh, kopshtesh apo edhe në infrastrukturë nga Bashkia Divjakë.

Bashkia Lushnjë

Të dhëna mbi numrin e kopshteve dhe çerdheve në Bashkinë Lushnjë 2019-2023

Njësia Administrative	Urbane	Rurale	Çerdhe	Kopshte	Ofrohet transport publik
NjA Lushnjë	X		PO(2)	PO	JO
NjA Golem		X	JO	PO	JO
NjA Dushk		X	JO	PO	JO
NjA Bubullimë		X	JO	PO	JO
NjA Fiershegan		X	JO	PO	PO
NjA Allkaj		X	JO	PO	PO
NjA Ballagat		X	JO	PO	JO
NjA Kolonjë		X	JO	PO	PO
NjA Hysgjokaj		X	JO	PO	JO
NjA Krutje		X	JO	PO	PO
NjA Karbunarë		X	JO	PO	JO
NjA Savër		X	JO	PO	JO

Burimi: Bashkia Lushnjë, përpunoi grupi i auditimit

Referuar të dhënave të paraqitura nga Bashkia Lushnjë, konstatohet se për çdo vit objekt auditimi, popullsia për çdo njësi administrative nuk është përcaktuar. Kjo Bashki ka 12 njësi administrative, ndër të cilat 1 njësi urbane dhe 11 njësi rurale. Në 11 njësi administrative rurale të Bashkisë Lushnjë nuk ka çerdhe, ndërsa kopshte ka në çdo njësi administrative. Sa i përket transportit publik, ai sigurohet vetëm në 4 njësi administrative rurale të kësaj Bashkie.

Sa i përket të dhënave në lidhje me investimet në kopshte e çerdhe të ndara sipas NjA rurale/urbane për vitet 2019-2023, nga Bashkia Lushnjë janë si vijojnë:

- Për vitin 2021 ka financuar Ndërtimin e Kopshteve në 1 njësi administrative urbane në vlerën 912, 000 lekë.
- Për vitin 2022 ka financuar ndërtimin e kopshteve në 1 njësi administrative urbane në vlerën 946,800 lekë.
- Për vitin 2023 ka financuar ndërtimin e kopshteve dhe çerdheve në 1 njësi administrative urbane në vlerën 218,139 lekë dhe 6,834,865 lekë.

Bashkia Pogradec

Të dhëna mbi numrin e kopshteve dhe çerdheve në Bashkinë Pogradec 2019–2023

Njësia Administrative	NJA Urbane	NJA Rurale	Nr. i Çerdheve	Nr. i Kopshteve	Ofrohet transport publik
Pogradec	x		1	5+3 (Preschool class)	Po
Buçimas		X	-	7	Po
Çërrava		X	-	9	Po
Udënisht		X	-	6	Po
Proptisht		X	-	9	Po
Velçan		X	-	3	Po
Trebinjë		X	-	4	Po
Dardhas		X	-	3	Po
Total	1	7	1	49	

Burimi: Bashkia Pogradec, përpunoi grupi i auditimit

Të dhëna mbi numrin e banorëve në Bashkinë Pogradec 2019–2023

Nr. banorësh 2019	Nr. banorësh 2020	Nr. banorësh 2021	Nr. banorësh 2022	Nr. banorësh 2023
91,902	92,016	91.838	91.955	91.970

Burimi: Bashkia Pogradec

Referuar të dhënave zyrtare nga Bashkia Pogradec, konstatohet se për çdo vit objekt auditimi, popullsia përgjithësisht ka ndryshuar, por nuk ka ndryshuar numri i çerdheve dhe kopshteve në raport me numrin e banorëve në total të çdo njësie administrative të Bashkisë Pogradec. Kjo Bashki ka 8 njësi administrative, ndër të cilat 1 njësi urbane dhe 7 njësi rurale. Në 7 njësi administrative rurale të Bashkisë Pogradec nuk ka çerdhe, ndërsa kopshte ka në çdo njësi administrative. Sa i përket transportit publik, nuk ka të dhëna nëse ai sigurohet për njësitë administrative rurale/urbane të kësaj Bashkie.

Sa i përket të dhënave në lidhje me investimet në kopshte e çerdhe të ndara sipas NjA rurale/urbane për vitet 2019–2023, nga Bashkia Pogradec janë si vijojnë:

- Për vitin 2020 ka pasur dy investime në 2 njësi administrative rurale/urbane në infrastrukturë në vlerën 48,980,008 lekë,
- Për vitin 2021 ka pasur dy investime në 2 njësi administrative rurale/urbane në infrastrukturë në vlerën 193,919,996 lekë,
- Për vitin 2021 ka pasur dy investime në 2 njësi administrative rurale/urbane në infrastrukturë në vlerën 193,919,996 lekë,
- Për vitin 2022 ka pasur një investim në 1 njësi administrative urbane në infrastrukturë në vlerën 141,562,1766 lekë,
- Për vitin 2019 dhe vitin 2023, nuk ka pasur investime për ndërtim çerdhesh, kopshtesh apo edhe në infrastrukturë nga Bashkia Divjakë.

Në vitin 2020, Bashkia Pogradec, pas konsultimeve me përfaqësues të komunitetit të zonës dhe me qëllim përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë të shërbimit arsimor për të gjithë nxënësit në institucionet arsimore parauniversitare publike, ka ndërmarrë iniciativën për:

1. Hapjen dhe funksionimin e Institucionit Arsimor Publik Parashkollor “Kopsht”, në fshatin Homçan, Njësia Administrative Proptisht, Bashkia Pogradec.
2. Hapjen dhe funksionimin e Institucionit Arsimor Publik Parashkollor “Kopsht”, në fshatin Losnik, Njësia Administrative Velçan, Bashkia Pogradec.
3. Nga këto dy propozime të dërguara pranë Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, u arrit në vitin 2020 hapja e një grupi të përzier në fshatin Homçan.

Bashkia Gjirokastrë

Të dhëna mbi numrin e kopshteve dhe çerdheve në Bashkinë Gjirokastrë 2019–2023

Njësia Administrative	Urbane	Rurale	Çerdhev	Kopshtev	Nr. banorësh	Ofrohet transport publik
Gjirokastrë	X		PO	PO		PO
Picar		X	JO	PO	2,800	PO
Antigonë		X	JO	PO	1,700	PO
Lazarat		X	JO	PO	3,000	PO
Lunxheri		X	JO	PO	5,000	PO
Cepo		X	JO	PO	3,000	PO
Odrie		X	JO	PO	1,600	PO
Total					17,100	

Burimi: Bashkia Gjirokastrë, përpunoi grupi i auditimit

Referuar të dhënave të paraqitura nga Bashkia Gjirokastrë konstatohet se për çdo vit objekt auditimi, të dhënat zyrtare janë të njëjta. Numri i banorëve për njësi administrative nuk ka ndryshuar, por nuk ka ndryshuar as numri i çerdheve dhe kopshteve në raport me numrin e banorëve në total të çdo njësie administrative të Bashkisë Gjirokastrë. Kjo Bashki ka 7 njësi administrative, ndër të cilat 1 njësi urbane dhe 6 njësi rurale. Në 6 njësi administrative rurale të Bashkisë Gjirokastrë nuk ka çerdhe, ndërsa kopshte ka në çdo njësi administrative. Sa i përket transportit publik, ai sigurohet për të gjitha njësitë administrative rurale/urbane të kësaj Bashkie.

Sa i përket të dhënave në lidhje me investimet në kopshte e çerdhe të ndara sipas NjA rurale/urbane, nga Bashkia Gjirokastrë, për vitin 2023 ka pasur vetëm një investim në infrastrukturë në vlerën 1,634,833 lekë. Për periudhën 2019–2022, nuk ka pasur investime për ndërtim çerdhesh, kopshtesh apo edhe në infrastrukturë.

Bashkia Vlorë

Të dhëna mbi numrin e kopshteve dhe çerdheve në Bashkinë Vlorë 2019–2023

Njësia Admin.	Viti 2019		Viti 2020		Viti 2021		Viti 2022		Year 2023	
	Çerdhe	Kopshte	Çerdhe	Kopshte	Çerdhe	Kopshte	Çerdhe	Kopshte	Crèches	Kindergar.
Vlora	3	19	3	19	3	19	3	19	3	19
Orikum	-	4	-	3	-	3	-	3	-	3
Qendër	-	10	-	10	-	10	-	10	-	8
Shushica	-	4	-	4	-	4	-	4	-	4
Novosele	-	10	-	10	-	9	-	8	-	8

Burimi: Bashkia Vlorë, përpunoi grupi i auditimit

Referuar të dhënave zyrtare nga Bashkia Vlorë, konstatohet se kjo Bashki ka 5 njësi administrative, ndër të cilat 1 njësi urbane dhe 4 njësi rurale. Në 4 njësi administrative rurale të Bashkisë Vlorë nuk ka çerdhe, ka vetëm në njësinë urbane. Ndërsa kopshte ka në çdo njësi administrative. Sa i përket transportit publik, nuk ka informacion nëse ai sigurohet për të gjitha njësitë administrative rurale/urbane të kësaj Bashkie.

Bashkia Dibër

Të dhëna mbi numrin e kopshteve dhe çerdheve në Bashkinë Dibër 2019–2023

Njësia Administrative	Urbane	Rurale	Çerdhev	Kopshtev	Nr. banorësh	Ofrohet transport publik
NjA Peshkopi	X		Po (3)	Po (7)	18,950	Jo
NjA Maqellarë		X	Po (2)	Po (5)	13,632	Po
NjA Melan		X	Jo (0)	Po (7)	4,415	Po
NjA Tomin		X	Po (1)	Po (6)	8,489	Po
NjA Kastriot		X	Jo (0)	Po (6)	7,323	Po
NjA Lurë		X	Jo (0)	Jo (0)	1,482	Po
NjA Sllovë		X	Jo (0)	Po (3)	3,184	Po
NjA Kala e Dodës		X	Jo (0)	Po (3)	3,014	Po
NjA Zall-Dardhë		X	Jo (0)	Po (1)	-	Po
NjA Zall-Reç		X	Jo (0)	Jo (0)	2,346	Po
NjA Fushë Cidhen		X	Jo (0)	Po (5)	3,611	Po
NjA Arras		X	Jo (0)	Po (4)	3,841	Po
NjA Selishtë		X	Jo (0)	Jo (0)	1,961	Po
NjA Luzni		X	Jo (0)	Po (3)	3,176	Po
NjA Muhurr		X	Jo (0)	Po (4)	3,516	Po
Total			6	54	78,940	

Burimi: Bashkia Dibër, përpunoi grupi i auditimit

Referuar të dhënave të paraqitura nga Bashkia Dibër, konstatohet se për çdo vit objekt auditimi, të dhënat zyrtare janë të njëjta. Numri i banorëve për njësi administrative nuk ka ndryshuar, por as numri i çerdheve dhe kopshteve në raport me numrin e banorëve në total të çdo njësie administrative të Bashkisë Dibër. Kjo Bashki ka 15 njësi administrative, ndër të cilat 1 njësi urbane dhe 14 njësi rurale. Në 12 njësi administrative rurale të Bashkisë Dibër, nuk ka çerdhe, ndërsa kopshte nuk ka në 3 njësi administrative rurale. Sa i përket transportit publik, ai sigurohet në 14 njësitë administrative rurale të kësaj Bashkie.

Sa i përket të dhënave në lidhje me investimet në kopshte e çerdhe të ndara sipas NjA rurale/urbane, nga Bashkia Dibër, për periudhën 2019–2023, nuk ka pasur investime për ndërtim çerdhesh, kopshtesh apo edhe në infrastrukturë.

Bashkia Berat

Të dhëna mbi numrin e kopshteve dhe çerdheve në Bashkinë Berat 2019–2023

Njësia Admis.	Urbane	Rurale	Çerdhe	Kopshte	Nr. banorësh 2019	Nr. banorësh 2020	Nr. banorësh 2021	Nr. banorësh 2022	Nr. banorësh 2023	Ofrohet transport publik
Berat	X		Po	Po	63,505	63,406	63,408	63,490	63,432	Po
NjA Velabisht		X	Jo	Po	12,084	12,109	11,962	11,950	11,956	Po
NjA Sinjë		X	Jo	Po	5,235	5,224	5,190	5,183	5,021	Po
NjA Roshnik		X	Jo	Po	3,896	3,672	3,658	3,602	3,574	Po
NjA Otlak		X	Jo	Po	15,475	15,540	15,575	15,533	15,570	Po
Total					100,195	99,951	99,793	99,758	99,553	

Burimi: Bashkia Berat, përpunoi grupi i auditimit

Referuar të dhënave të paraqitura më sipër, rezulton se në Bashkinë Berat janë gjithsej 5 njësi administrative, nga të cilat 1 është urbane dhe 4 janë rurale. Çerdhe ka vetëm në NjA qendër (Berat) ndërsa në 4 NjA rurale, nuk ka shërbim çerdhe.

Të dhëna mbi investimet në kopshte, çerdhe dhe infrastrukturë në Bashkinë Berat 2019–2023

Administ. Unit	Year 2020		Year 2021		Year 2022			Year 2023			
	Investim Çerdhe (a)	Investim Kopshte (b)	(a)	(b)	Investim Infrastrukturë (c)	(a)	(b)	(c)	(a)	(b)	(c)
NjA Berat	600,000	550,000	800,000	1,200,000		400,000	540,000		670,000	756,000	
NjA Sinjë	0	230,553	0	321,000		0	125,000	11,452,141	0	256,770	
NjA Roshnik	0	112,300	0	124,445		0	90,000	11,803,149	0	157,880	11,452,141
NjA Velabisht	0	325,000	0	411,321		0	170,000	11,452,141	0	223,000	9,365,040
NjA Otlak	0	231,660	0	377,400	438,068,428	0	220,442	11,452,141	0	200,000	9,365,039

Burimi: Bashkia Berat

Popullsia banuese sipas rajoneve, Nomenklatura e Ndarjes Territoriale për Qëllime Statistike (NUTS 3) dhe ndarja urbane-rurale

Nr.	Emri i Qarkut	Popullsia urbane	Popullsia rurale	% e popullsisë urbane	% e popullsisë rurale
1	BERAT	61,403	80,557	43,3	56,7
2	DIBËR	34,754	102,308	25,4	74,6
3	DURRËS	149,199	114,488	56,6	43,4
4	ELBASAN	112,267	184,589	37,8	62,2
5	FIER	112,855	199,865	36,1	63,9
6	GJIROKASTËR	36,567	37,287	49,5	50,5
7	KORÇË	87,791	133,116	39,7	60,3
8	KUKËS	26,772	58,655	31,3	68,7
9	LEZHË	49,896	85,217	36,9	63,1
10	SHKODËR	90,743	125,332	42,0	58,0
11	TIRANË	478,127	278,801	63,2	36,8
12	VLORË	106,906	74,482	58,9	41,1
Total		1,347,280	1,474,697	47,7	52,3

Burimi: INSTAT - Censusi i popullsisë dhe banesave në Shqipëri, 2011.

Në referencë të të dhënave të paraqitura në tabelën më sipër, por edhe të dhënave të tjera të konsultuara nga INSTAT, vërehet se në pjesën më të madhe të qarqeve të vendit tonë, mbizotëron popullsia rurale. Referuar të dhënave të vitit 2014, nga 12 qarqe që ka vendi ynë, në 9 qarqe mbizotëron kategoria e popullsisë rurale, në 2 qarqe (Durrës dhe Vlorë) kategoria e popullsisë së ndërmjetme dhe në 1 qark (Tiranë) kategoria e popullsisë urbane.

Theksojmë, që në ditët e sotme, këto të dhëna mund të kenë ndryshuar, por meqë nga bashkitë nuk na u paraqitën të dhëna të përditësuara, po i referohemi të dhënave të INSTAT të vitit 2014.



Gjetje:

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i të dhënave të grumbulluara nga Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore objekt auditimi, u konstatua se pothuajse në 80 % të tyre, raporti i çerdheve dhe kopshteve nuk është në proporcion të drejtë me njësitë administrative rurale dhe ato urbane, që i përkasin një Bashkie. Referuar të dhënave zyrtare nga Bashkitë objekt auditimi, konstatohet se çerdhet mungojnë në njësitë administrative rurale dhe në disa raste edhe në njësitë administrative urbane. Për rrjedhojë, nuk sigurohet një mbulim i plotë dhe ndarje e drejtë sipas zonave urbane dhe rurale, me kopshte dhe çerdhe.

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i të dhënave të grumbulluara nga Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore objekt auditimi, u konstatua se në disa njësi të qeverisjes vendore nuk sigurohet transport publik, përveçse në njësitë administrative urbane. Për rrjedhojë, nuk sigurohen kushte lehtësimi, për të afruar gratë dhe vajzat sa më afër tregut të punës.



Konkluzione:

1. Konkluzion: Mungesa e çerdheve pothuajse në të gjitha NjA rurale, si dhe mungesa e kopshteve në disa prej tyre, ndikon drejtpërsëdrejti në nivelin e punësimit të grave nga zonat rurale dhe nuk i zvogëlojnë barrierat për t'i afruar gratë, të rejat dhe vajzat sa më afër tregut të punës.
2. Konkluzion: Mangësitë në mbulimin me transport dhe infrastrukturë logjistike, sidomos në njësitë administrative rurale, pengojnë forcimin e pozitës së gruas në shoqëri dhe në qasjen e saj drejt tregut të punës.



Rekomandime:

1.1 Rekomandim:

Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore, në përputhje me strategjitë rajonale për zhvillimin e zonave rurale, të marrin masa për të vlerësuar situatën në këto zona, për mbulimin e tyre me çerdhe dhe kopshte si dhe të hartojnë plane investimesh në varësi të nevojave proporcionale me numrin e banorëve.
[Brenda vitit 2024](#)

2.1 Rekomandim:

Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore, të marrin masa për të identifikuar dhe vlerësuar nevojat që ka për mbulimin me transport publik në çdo njësi administrative, për ta afruar atë nga zonat rurale drejt zonave urbane.
[Brenda vitit 2024](#)

2.2 Rekomandim:

Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore, të vlerësojnë gjendjen e infrastrukturës në zonat rurale dhe të hartojnë një plan investimesh në varësi të situatës, të numrit të banorëve dhe nevojave të konstatuara.
[Brenda vitit 2024](#)

5.3 A ka ndërveprim të institucioneve qendrore me strukturat vendore për nxitjen e punësimit të grave rurale?

Nga të dhënat e administruara nga AKPA, konstatohet se niveli i papunësisë është më i theksuar tek gratë, banorët në zonat rurale apo personat me arsimim më të ulët etj... Gratë dhe vajzat rezultojnë dukshëm në një pozitë më të pafavorshme në të gjithë treguesit e punësimit.

Indicator	2019		2020		2021	
	Males	Female	Males	Female	Males	Female
Shkalla e pjesëmarrjes në forcat e punës	68.0	53.0	66.9	52.3	67.2	52.6
Shkalla e punësimit	60.1	46.9	59.2	46.1	59.5	46.4
Shkalla e papunësisë	11.6.	11.4.	11.5.	11.9	11.3	11.8
Përqindja e të papunëve afatgjatë	63.1	63.7	59.7	59.1	60.5	65.5
Shkalla e papunësisë afatgjatë	7.3	7.3	6.9	7.1	6.9	7.7
Shkalla e inaktivitetit	32.0	47.0	33.1	47.7	32.8	47.4

Burimi i të dhënave: AKPA

Referuar të dhënave të INSTAT-it, informaliteti në tregun e punës përbën ende një problem në vendin tonë. Gjatë vitit 2021, një në pesë persona të punësuar, punon pa pagesë në biznesin e familjes dhe ky tregues është më i lartë për femrat, sesa për meshkujt, si dhe konstatohet edhe në punësimin në zonat rurale.

Strategjia Kombëtare për Barazinë Gjinore dhe Plani i Veprimit 2016–2020, qëllimin e parë strategjik kanë *“Fuqizimin ekonomik të grave dhe burrave”*. Ky qëllim ka objektiva që lidhen me rritjen e pjesëmarrjes në tregun e punës të grave dhe vajzave si pasojë e zbatimit të Strategjisë së Punësimit dhe Aftësisë 2014–2020 nën këndvështrimin gjinor. Gjithashtu, ka edhe një objektiv specifik që është përkatësisht për fuqizimin ekonomik të grave në zonat rurale.

Në Strategjinë Kombëtare për Barazinë Gjinore dhe Planin e Veprimit 2021–2030, qëllimi strategjik *“Fuqizimi ekonomik i grave dhe burrave”*, është zgjeruar më tej, duke synuar jo vetëm fuqizimin socio-ekonomik të grave, të rejave e vajzave **nga të gjithë grupet, pra edhe nga zonat rurale**, por edhe avancimin drejt ekonomisë mjedisore dhe digjitalizimit. Për të përmbushur këtë qëllim, një ndër objektivat është edhe *“Rritja e aksesit të grave, të rejave dhe vajzave, nga të gjithë grupet në shërbimet dhe produktet financiare, si dhe në burimet produktive”*. Në zbatim të këtyre objektivave si dhe në zbatim të Strategjisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësisë 2019–2022, u shqyrtua nga grupi i auditimit aktiviteti i institucioneve në nivel qendror dhe vendor lidhur me fokusin e auditimit tonë, *“punësimin e grave nga zonat rurale”*. Me përfundimin e SKPA 2019–2022, është hartuar strategjia e re e punësimit 2023–2030, e cila nuk është miratuar ende.

Në zbatim të objektivave të Strategjisë Kombëtare për Punësim dhe Aftësi 2019–2022, është përcaktuar që AKPA do të zhvillojë disa aktivitete që kanë si qëllim të vendosin ndërveprim të institucioneve qendrore me strukturat vendore për nxitjen e punësimit në përgjithësi. Përkatësisht, nga AKPA duhet të merren të gjitha masat që të zbatohet plani i shërbimeve në zonat e pambuluara¹⁹. Për të realizuar këtë, do të nënshkruhen marrëveshje bashkëpunimi me Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore në të cilat do të përcaktohen rolet reciproke, si dhe lloji i shërbimeve që do të ofrohen në zonat e pambuluara me zyra punësimi. Gjithashtu, do të ngrihen pika shërbimi pranë Njësive të Vetëqeverisjes Vendore. *Zbatimi i marrëveshjeve të bashkëpunimit, të nënshkruara midis AKPA-së dhe NJQV-ve Lezhë, Elbasan dhe Lushnjë.*

Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësisë, në kuadër të forcimit dhe të bashkërendimit të politikave

19. Strategjia Kombëtare për Punësim dhe Aftësi 2019–2022, Objektiv C, faqja 19.

të punësimit në nivel rajonal dhe vendor, ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore. Përkatësisht, që nga miratimi i SKPA në vitin 2019 dhe deri në vitin 2021, janë nënshkruar 16 akt-marrëveshje me bashki të ndryshme (Elbasan, Gramsh, Librazhd, Peqin, Cërrik, Përrenjas, Fier, Lushnjë, Patos, Roskovec, Korçë, Maliq, Lezhë, Laç, Mirditë dhe Delvinë). Nga këto 16 akt-marrëveshje, grupi i auditimit auditoi zbatimin e 3 akt-marrëveshjeve të lidhura me bashkitë që janë objekt i auditimit si Bashkitë Lushnjë, Lezhë dhe Elbasan.

Me Bashkinë Lushnjë, është nënshkruar akt-marrëveshja me nr. 160 Prot. datë 17.01.2022, me Bashkinë Lezhë akt-marrëveshja nr. 20663 Prot. datë 06.12.2021, me Bashkinë Elbasan akt-marrëveshja nr. 3772 Prot. datë 17.12.2020. Këto akt-marrëveshje, kanë një afat dyvjeçar, që fillon nga data e nënshkrimit dhe përcaktojnë përgjegjësitë e bashkive dhe të AKPA-s, në kuadër të nxitjes së punësimit.

Palët nënshkruese të marrëveshjeve, marrin përsipër të bashkëpunojnë midis tyre, për të bërë të mundur mbështetjen institucionale dhe integrimin e punëkërkuarve në tregun e punës. Qëllimi është që të bashkërendohen përpjekjet institucionale në nivel qendror, rajonal dhe vendor me objekt kryesor uljen e nivelit të papunësisë dhe trajtimin sa më efektiv të problematikave sociale me të cilat përballen individët në këto bashki.

Referuar akt-marrëveshjeve në përgjithësi, të tre bashkitë angazhohen që:

1. Drejtoria e cila merret me ndjekjen e çështjeve sociale, nëpërmjet strukturave vartëse dhe administratorëve shoqërorë të bashkive dhe njësive administrative, të orientojnë personat e aftë për punë, që të regjistrohen pranë zyrave të punësimit për të mundur përfitimin nga shërbimet dhe programet që ato ofrojnë: këshillim, ndërmjetësim për punë, formim profesional apo pjesëmarrje në programet e nxitjes së punësimit;
2. Ndërlidhjen e faqeve web me qëllim rritjen e aksesit të publikut në burimet e informacionit për përgatitjen për tregun e punës;
3. Zhvillimin e aktiviteteve të përbashkëta (p.sh., panairët vjetore) që nxisin dhe përkrahin fushën e punësimit, vendosin lidhjet punëdhënës-punëkërkuar, rrisin dhe përmirësojnë ekonominë lokale, forcojnë nismat e partneritetit publik dhe privat, si dhe ruajnë kontaktet me investitorë potencialë; vendosja dhe intensifikimi i formave të reja të bashkëpunimit ndërmjet palëve;
4. Sigurimi i kontigjentit dhe promovimi i partneritetit me ndërmarrje të rëndësishme për zhvillimin e praktikave të punës, si p.sh., intershipe, programe trajnimi gjatë punës, etj.;
5. Partneriteti me ndërmarrje të rëndësishme për zhvillimin e profileve të reja profesionale dhe paketa formimi të hartuara në bazë të kompetencave sipas nevojave të vetë ndërmarrjeve për të rinj dhe të reja, si dhe shkëmbimi i informacioneve dhe kontakteve të vlefshme me qëllim rritjen e bashkëpunimit me sipërmarrësit që veprojnë në njësinë administrative;
6. Ofrimi i ambienteve për vendosjen e stafit të Zyrave të Punës, në bashkitë të cilat nuk kanë zyrë vendore të Punësimit;
7. Bashkëpunimi institucional me qëllim mbulimin e gjithë hapësirës administrative me shërbime punësimi dhe ndërmjetësimi, nëpërmjet mbajtjes së një regjistri për punëkërkuarët dhe punëdhënësit nga Administratori Shoqëror pranë Njësive Administrative (për Njësitë Administrative që janë në distancë të largët nga Zyrat Vendore të Punës), dhe dërgimi i këtij regjistri çdo datë 25 të muajit pranë Zyrës Vendore të Punës, në mënyrë që personat e regjistruar si të interesuar për të marrë shërbime punësimi, të kontaktohen më pas nga punonjësit e Zyrave të Punës;
8. Orientimi për regjistrimin pranë Zyrave të Punës, në kuadër të rritjes së ndërveprimit, të të gjitha vendeve të lira të punës, duke u fokusuar tek ato pozicione pune, procedurat e rekrutimit të të cilave, nuk kërkojnë aplikim sipas portaleve të institucioneve të tjera;
9. Vendosja e një personi kontakti në çdo Njësi Administrative apo Njësi të Qeverisjes Vendore, i cili do të koordinojë punën dhe do të mbajë kontakte të vazhdueshme me personin e kontaktit të Zyres Vendore të Punës.

AKPA, nga ana e saj, angazhohet që do të realizojë:

1. Shkëmbimin e informacionit, lidhur me të dhënat mbi anëtarët në moshë pune të familjeve përfituese të skemave të ndihmave sociale, nëpërmjet raportit që gjenerohet në Regjistrin Elektronik Kombëtar të Sistemit të Shërbimeve të Punësimit apo nga ndërveprimi i dy sistemeve përkatëse;
2. Informon bashkitë lidhur me të dhënat mbi anëtarët në moshë pune të familjeve që refuzohen nga skema e ndihmës ekonomike, të cilët janë paraqitur në sportelet e zyrave të punësimit dhe informon mbi rastet që janë ndërmjetësuar për punë dhe sa kanë përfituar nga programet e formimit profesional;
3. Referon pranë bashkive individët të cilët janë potencial për punësim, por që paraqesin problematika të tjera sociale;
4. Cakton një punonjës përgjegjës në çdo Zyrë Vendore Punësimi, që mban lidhje të vazhdueshme mbi ecurinë dhe zbatimin e kësaj marrëveshjeje me personin përgjegjës.

Nga auditimi lidhur me zbatimin e detyrimeve të përcaktuara në të tri akt-marrëveshjet, rezulton se:

- Përgjithësisht, personat e aftë për punë që drejtohen pranë zyrave të bashkive, orientohen që të regjistrohen pranë zyrave të punësimit, për të mundësuar përfitimin nga shërbimet dhe programet për këshillim, ndërmjetësim për punë, apo pjesëmarrje në programet e nxitjes së punësimit. Rezulton që ky proces, nuk dokumentohet nga ana e strukturave të bashkive;
- Në asnjërën nga tre bashkitë, nuk konstatohet një ndërlidhje e faqeve web me qëllim rritjen e aksesit të publikut në burimet e informacionit për përgatitjen për tregun e punës;
- Bashkitë, në përgjithësi, kanë zhvilluar aktivitete të përbashkëta që nxisin dhe përkrahin punësimin apo vendosin lidhjet punëdhënës-punëkërkues, por këto aktivitete pothuajse nuk dokumentohen nga strukturat e bashkive. Përgjatim bën vetëm Bashkia Lezhë, ku konstatohet një dokumentim më i plotë i këtyre aktiviteteve.
- Nuk është e formalizuar dhe dokumentuar nëse realizohet dhe si realizohet mbulimi i gjithë hapësirës administrative me shërbime punësimi dhe ndërmjetësimi. Nuk rezulton që, nga Administratori Shoqëror pranë njësive administrative që janë në distancë të largët nga Zyrat Vendore të Punës, të mbahet një regjistër për punëkërkuesit dhe punëdhënësit, i cili më pas të dërgohet periodikisht pranë Zyrës Vendore të Punës, në mënyrë që personat e regjistruar si të interesuar për të marrë shërbime punësimi, të kontaktohen më pas nga punonjësit e Zyrave të Punës;
- Nuk është caktuar një person kontakti në çdo Njësi Administrative për të koordinuar punën dhe për të mbajtur kontakte të vazhdueshme me personin e kontaktit të Zyrës Vendore të Punës;
- Nga përfaqësuesit e bashkive në regjistrin elektronik kombëtar të ndihmës ekonomike, plotësohet dritarja që referon individët madhorë në moshë punë, të cilët janë përfitues të ndihmës ekonomike.

Lidhur me detyrat e AKPA-s në këto akt-marrëveshje, rezulton se ato përgjithësisht kryhen pasi janë aktivitete të proceseve të punës së agjencisë. Nuk rezulton që AKPA të ketë informacion të plotë dhe të dokumentuar lidhur me ecurinë e marrëveshjeve, p.sh., të jetë hartuar ndonjë dokument lidhur me efektivitetin e tyre, apo si kanë ndikuar këto akt-marrëveshje në përmirësimin e situatës së punësimit me qëllim që të bëhen shembull aplikimi për në bashkitë e tjera të vendit.

Identifikimi i faktorëve që pengojnë përfshirjen e grave nga zonat rurale në tregun e punës.

Një ndër detyrat e NJQV²⁰, është që të sigurojnë qeverisje efektive dhe në një nivel sa më afër qytetarëve, nëpërmjet realizimit të shërbimeve në forma të përshtatshme, në përputhje me standardet e kërkuara me ligj ose akte të tjera normative. Në këtë kuadër, bashkitë realizojnë në vijimësi aktivitete, si dhe takime në terren me grupe të ndryshme individësh, ku përfshihen edhe takime me gratë në zonat rurale. Në këto takime, ku gratë shprehin problemet dhe shqetësimet e tyre të përgjithshme, punësimi është një prej tyre. Referuar të dhënave të paraqitura nga të gjitha bashkitë nën auditim, faktorët

20. Ligji nr. 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore" i ndryshuar, neni 3.

kryesorë të evidentuar gjatë takimeve dhe që pengojnë përfshirjen e grave nga zonat rurale në tregun e punës, janë kryesisht:

- Mentaliteti, ku gratë janë të prirura të merren kryesisht me punët e shtëpisë apo angazhohen në punët e bujqësisë familjare, duke rezultuar si të papuna;
- Emigrimi i burrave, duke sjellë që gratë të jenë të vetme në kujdesin ndaj familjes (fëmijëve dhe të moshuarve);
- Mungesa e linjave të rregullta të transportit publik nga Njësitë Administrative, ose linja transporti me orare të kufizuara;
- Mungesa pothuajse e plotë e çerdheve;
- Mungesa e kopshteve, (ose edhe në ato NJA ku ka kopshte, ato janë pa drekë), duke bërë që fëmijët të merren nga kopshti në mesditë. Si pasojë, nuk mundëson që gratë të mund të punojnë me orar të plotë;
- Mungesa e arsimit dhe aftësive profesionale (kryesisht gratë në zonat rurale kanë kryer vetëm arsimin e detyrueshëm).

Meqenëse faktorët e sipërcituar janë me ndikim të drejtpërdrejtë në nivelin e punësimit të grave në zonat rurale, është e nevojshme që marrja e masave për zvogëlimin e ndikimit të tyre të jetë në objektivat e institucioneve vendore dhe qendrore në të ardhmen.

Fushatat e ndërgjegjësimit apo aktivitete të tjera lidhur me punësimin e grave nga zonat rurale.

Ndërmarrja e fushatave të ndërgjegjësimit, apo dhe zhvillimi i aktiviteteve informuese që mund të kenë ndikim në rritjen e punësimit të grave nga zonat rurale, është faktor i rëndësishëm dhe parashikohet në SKPA. Grupi i auditimit, vlerësoi nëse bashkitë objekt auditimi, në bashkëpunim me AKPA-në, kanë zhvilluar aktivitete të këtij lloji. Rezulton se, kryesisht të gjitha bashkitë kanë zhvilluar aktivitete informuese apo panairë me fokus gratë në përgjithësi dhe, rast pas rasti, edhe gratë e zonave rurale. Madje, në Bashkinë Shkodër, janë realizuar edhe takime informimi apo seanca trajnimi që lidhen me gratë nga zonat rurale dhe punësimin.

Lidhur me këto aktivitete, përgjithësisht bashkitë, nuk kanë të dhëna se sa ndikim kanë patur në punësimin e grave nga zonat rurale. Vetëm në rastin e Bashkive Shkodër dhe Divjakë, ka të dhëna lidhur me përfitueset femra dhe zonat gjeografike të tyre. AKPA, nga ana e saj, në bashkëpunim me NJQV-të, ka organizuar rast pas rasti panairë të punës. Ajo që konstatohet është se, nga këto aktivitete, nuk rrjedhin nisma të tjera që të lidhen me gratë rurale.

Ngritja e pikave të shërbimit pranë njësive të qeverisjes vendore.

Referuar përcaktimeve të SKPA-së, një ndër aktivitetet që do të zhvillohet për të bërë të mundur zbatimin e planit të shërbimeve në zonat e pambuluara, do të jetë edhe ngritja e pikave të shërbimit pranë njësive të qeverisjes vendore. Nga 13 bashkitë në auditim 12 kanë zyra rajonale apo zyra vendore punësimi, ndërsa Bashkia Divjakë nuk ka zyrë, por mbulohet nga Zyra e Punësimit Lushnjë. Rezulton se në Bashkinë Divjakë, nuk ka pikë shërbimi të dedikuar në shërbimin e punësimit dhe, në institucion, nuk ka punonjës të ngarkuar nga AKPA për trajtimin e çështjeve të punësimit. Gjithashtu, nga AKPA, nuk na u paraqit lista e bashkive që kanë pika shërbimi për çështjet e punësimit, në mungesë të zyrave vendore të punësimit.

Bashkëpunimi midis Njësive të Vetëqeverisjes Vendore dhe Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive.

Në kuadër të zbatimit të programeve të nxitjes së punësimit, përkatësisht VKM-së nr. 535, datë 8.7.2020 "Për procedurat, kriteret dhe rregullat për zbatimin e Programit të Punëve Publike në Komunitet", ku një pjesë e madhe e institucioneve ofruese janë bashkitë, ka pasur një bashkëpunim midis AKPA-s dhe njësive vendore; por ky program punësimi, nuk lidhet veçanërisht me punësimin e grave të zonave rurale. Gjithashtu, AKPA apo bashkitë, nuk kanë të dhëna lidhur me përfitueset femra të zonave rurale nga ky program. Procesi i vetëm që në përgjithësi duket se funksionon, është

adresimi i punëkërkesve që paraqiten në zyrat e njësive vendore drejt zyrave të punës, duke qenë se 12 nga 13 bashkitë objekt auditimi, kanë zyra vendore punësimi. Gjithashtu, konstatohet se AKPA, gjatë vitit 2022, në bashkëpunim me 10 bashki (Elbasan, Fier, Durrës, Korçë, Lezhë, Shkodër, Belsh, Tiranë, Kamëz dhe Cërrik) dhe partnerë socialë, ka nisur zbatimin e një projekti pilot, për krijimin e një rrjeti referimi bashkëpunimi ndërmjet palëve me qëllim trajtimin, fuqizimin dhe integrimin social dhe ekonomik të individëve që i përkasin grupeve vulnerabël dhe emigrantëve të kthyer. Sa konstatohet nga informacioni i paraqitur nga AKPA, edhe ky projekt nuk ka në fokus gratë rurale. Aktualisht, AKPA ka një projekt që pritet të zbatohet në vijim, i cili përmban një paketë gjithëpërfshirëse shërbimesh dhe programesh punësimi, të përshtatura për gratë që banojnë në zonat rurale dhe zona të tjera që aktualisht nuk mbulohen plotësisht nga shërbimet publike të punësimit. Ky projekt, do të shtrihet në Bashkitë Elbasan, Lushnjë dhe Kamëz. Target-grupi i këtij projekti, mund të përkrahë që janë gratë që banojnë në njësitë administrative, të cilave u mungojnë strukturat vendore të shërbimeve të punësimit të AKPA-s ose ndodhen shumë larg çdo pike shërbimi ekzistuese të AKPA-s.

Monitorimi i zbatimit të politikave të punësimit.

Në Strategjinë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive 2019-2022, në zbatim të objektivit A "Mundësive për punë të denjë nëpërmjet politikave të frytshme në tregun e punës", dy qëllimet që janë marrë në vlerësim nga grupi i auditimit, janë:

- a) "Hartimi dhe diversifikimi i PATP-ve në bazë të nevojave të grupeve me rrezik të lartë për t'u bërë të papunë afatgjatë", i cili do të arrihet duke bërë të mundur midis të tjerave që, politikatat aktive të tregut të punës të jenë të përmirësuara, bazuar në rezultatet e monitorimit.
- b) "Zhvillimi dhe zbatimi i modelit për monitorimin e programeve aktive të tregut të punës (PATP) me ndjeshmëri për çështjet gjinore".

a) Në materialet e konsultuara nga grupi i auditimit, konstatohet se zbatimi i Strategjisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive, është monitoruar periodikisht për të katër objektivat e vendosura. Për secilin objektiv, janë hartuar raportet e monitorimit për vitet 2020-2021-2022. Monitorimi në vetvete, përveç vlerësimit të nivelit të arritjes së objektivave, ka edhe për qëllim përdorimin e rezultateve për të përmirësuar politikatat e tregut të punës në vijimësi.

Nga vlerësimi i rezultateve të monitorimit në fokus të objektivave të auditimit tonë, u analizua realizimi i aktivitetit lidhur me përmirësimin e politikave aktive të tregut të punës, bazuar në rezultatet e monitorimit. Konstatohet se, SKPA dhe ligji nr. 15/2019, datë 13.03.2019 "Për Nxitjen e Punësimit", janë miratuar në vitin 2019, ku më pas janë hartuar dhe miratuar gjithsej katër programe punësimi, si vijon:

- VKM nr.17, datë 15.01.2020 "Për procedurat, kriteret dhe rregullat për zbatimin e programeve të nxitjes së punësimit nëpërmjet punësimit, formimit në punë dhe praktikave profesionale", e ndryshuar;
- VKM nr. 348, datë 29.4.2020 "Për procedurat, kriteret dhe rregullat për zbatimin e programit të nxitjes nëpërmjet Vetëpunësimit";
- VKM nr. 535, datë 8.7.2020 "Për procedurat, kriteret dhe rregullat për zbatimin e Programit të Punëve Publike në Komunitet";
- VKM nr. 608, datë 29.07.2020 "Për procedurat, kriteret dhe rregullat për zbatimin e programit të nxitjes së punësimit të personave të dalë të papunë si pasojë e COVID-19", e ndryshuar.

Sikurse vihet re, të gjitha programet e punësimit janë miratuar gjatë vitit 2020, ose në vitin e parë të zbatimit të strategjisë së punësimit. Nga ana tjetër në raportet e monitorimit, aktiviteti për hartimin e politikave aktive të tregut të punës të përmirësuara bazuar në rezultatet e monitorimit, rezultojnë i përfunduar në vitin 2021. Sa më sipër, grupit të auditimit i rezultojnë se nuk ka programe punësimi të hartuara bazuar në rezultatet e monitorimit të strategjisë, si dhe nuk është e qartë se si ky aktivitet është klasifikuar si i realizuar nga AKPA. Nuk është e qartë se si janë përdorur konkretisht rezultatet e monitorimit për të përmirësuar politikatat e punësimit, apo cilat janë përmirësimet specifike që janë bërë në referencë të rezultateve të monitorimit.

b) Në zbatim të objektivit A.4 për zhvillimin dhe zbatimin e modelit për monitorimin e Programeve Aktive të Tregut të Punës (PATP) me ndjeshmëri për çështjet gjinore konstatohet se, kuadri metodologjik i vlerësimit dhe monitorimit i hartuar për PATP-të, është në progres. AKPA ka realizuar procesin e gjurmimit post-nxitje, për të gjithë pjesëmarrësit e programeve të nxitjes së punësimit, që kishin përfunduar gjatë vitit 2020. Për të përmbushur këtë aktivitet lidhur me çështjet gjinore, fokusi i AKPA-s ka qenë vetëm në vlerësimin e nivelit të punësueshmërisë sipas gjinive për çdo tregues. Edhe në raportin e gjurmimit për pjesëmarrësit në PNP, paraqiten rezultatet e punësimit apo aspekte të tjera me një ndarje femra/meshkuj. Sa më sipër, nuk rezulton që, në asnjë aspekt të monitorimit të zbatimit të objektivave të strategjisë, të ketë të dhëna për punësimin apo punëkërkuesit e papunë me grupim "gratë rurale". Nuk rezulton që gjatë procesit të monitorimit, të jenë hartuar informacione apo raporte, dhe të jenë grumbulluar të dhëna lidhur me problematikat që kanë rezultuar në realizimin e këtij aktiviteti.



Gjetje:

1. Gjetje nga auditimi:

Detyrimet e përcaktuara në akt-marrëveshjet e nënshkruara nga Bashkitë Lushnjë, Lezhë dhe Elbasan, nuk janë zbatuar. Nuk dokumentohen aktivitetet e zhvilluara në kuadër të nxitjes së punësimit. Njësisë Administrative që janë në distancë të largët nga Zyrat Vendore të Punës, nuk regjistrojnë punëkërkuesit në një regjistër, i cili më pas të dërgohet periodikisht pranë Zyrës Vendore të Punës. Gjithashtu, në Njësitë Administrative, nuk është caktuar një person me përgjegjësi për të koordinuar punën dhe për të mbajtur kontakte të vazhdueshme me Zyrën Vendore të Punës, për të adresuar çështjet e punësimit. AKPA, nga ana e saj, nuk ka dokumentuar ecurinë e zbatimit të marrëveshjeve të nënshkruara me Bashkitë Elbasan, Lushnjë dhe Lezhë. Gjithashtu, nuk është kryer një vlerësim mbi efektivitetin e tyre në përmirësimin e situatës së punësimit.

2. Gjetje nga auditimi:

Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive, nuk ka ngritur pika shërbimi në Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore, të cilat nuk kanë zyra vendore punësimi, me qëllim trajtimin e çështjeve të punësimit, sikundër është përcaktuar në Strategjinë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive.

3. Gjetje nga auditimi:

Shërbimet e punësimit të ofruara nga Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive, nuk janë plotësisht të bashkërenduara me njësitë e vetëqeverisjes vendore. Komunikimi midis strukturave qendrore dhe vendore, nuk identifikon nevojat e grave në përgjithësi dhe atyre rurale në veçanti.

4. Gjetje nga auditimi:

Edhe pse Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive e ka monitoruar periodikisht zbatimin e aktiviteteve të përcaktuara për t'u realizuar me qëllim arritjen e objektivave të Strategjisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive 2019-2022, nuk konstatohet se si janë përdorur konkretisht rezultatet e monitorimit për të përmirësuar politikat e punësimit, apo cilat janë përmirësimet specifike që janë bërë në referencë të rezultateve të monitorimit.



Konkluzione:

1. Strategjia Kombëtare për Barazinë Gjinore 2021–2030, për fuqizimin ekonomik të grave, synon fuqizimin socio-ekonomik të grave, përfshirë edhe grupin e “grave rurale”. Nga ana tjetër, Strategjia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive 2023–2030 (aktualisht në fazën e draftit për konsultim publik), planifikon si qëllim strategjik, mundësimin e punësimit të denjë për gra dhe burra, nëpërmjet zbatimit të politikave gjithëpërfshirëse të tregut të punës. Strategjia e Punësimit, nuk paraqet klasifikime të tjera brenda grupit të grave, ndryshe nga strategjia për barazi gjinore, e cila përfshin edhe grupin e grave nga zonat rurale. Pra, në SKPA 2023–2030 (draft), nuk është zbatuar parimi i përgjithshëm që, strategjitë kombëtare, duhet të jenë në harmoni me kornizën e SKZHIE 2030, ku përfshihet edhe SKBGJ 2021–2030.
2. Lidhur me objektin tonë të auditimit “*punësimi i grave në zonat rurale*”, parë në këndvështrimin se bashkitë janë institucioni i parë ku individët drejtohen për çdo problem, përfshirë këtu edhe kërkesën për punësim, nuk konstatohet që gratë në përgjithësi, apo gratë e zonave rurale, të përcaktohen si një grup më vete. Në dokumentet që përcaktojnë angazhimet e bashkive apo të AKPA-s, si p.sh., akt-marrëveshjet, nuk janë vendosur qëllime apo nuk janë përcaktuar aktivitete specifike për gratë në përgjithësi apo për gratë e zonave rurale në veçanti, me qëllim informimin e tyre për mundësitë e punësimit.
3. Në zbatimin e politikave të punësimit për fokus-grupin tonë “*gratë rurale*”, por jo vetëm, një rol themelor luan edhe koordinimi dhe bashkërendimi ndërinstytucional me njësitë e vetëqeverisjes vendore. Aktualisht, edhe pse ka një bashkëpunim midis Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive dhe bashkive, nuk mund të themi që ofrohen shërbimeve efektive për punëkërkesit, në rastin tonë, gratë rurale. Shkëmbimi i informacionit me njësitë e vetëqeverisjes vendore, nuk sjell trajtimin e problemeve që mbajnë gratë rurale larg tregut të punës.
4. Monitorimi i zbatimit të Strategjisë Kombëtare për Punësim dhe Aftësim 2019–2022, është kryer periodikisht për çdo aktivitet, si dhe janë hartuar raportet e monitorimit. Parë në fokusin e auditimit, konstatohet se të dhënat grupohen në gra dhe burra. Për asnjë aktivitet të strategjisë, nuk ka të dhëna që lidhen me gratë rurale. Gjithashtu, nuk konstatohet që monitorimi i kryerjes së aktiviteteve për zbatimin e objektivave të punësimit, të ketë shërbyer edhe për të identifikuar problematika apo për të trajtuar çështje për përmirësim. Nuk mund të kuptohet qartë, nëse janë hartuar politika për nxitjen e punësimit në referencë të rezultateve të monitorimit dhe, nëse po, çfarë politikash.



Rekomandime:

1.1 Rekomandim:

Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive, të monitorojë zbatimin e kushteve të marrëveshjeve aktive që ka me Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore. Në vijim, të synohet mbledhja e informacionit sipas njësive administrative me qëllim identifikimin e grave rurale që duan të punësohen. Gjithashtu, në akt-marrëveshjet që do të lidhë në vijim me bashkitë, të përfshijë edhe aktivitete me fokus në grupin e grave rurale.

[Deri në shtator 2024 dhe në vijimësi](#)

2.1 Rekomandim:

Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive, të bashkëpunojë me Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore për të ngritur pika shërbimi për trajtimin e çështjeve të punësimit, në ato bashki ku nuk ka zyra vendore punësimi.

[Deri në shtator 2024](#)

3.1 Rekomandim:

Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive, në bashkëpunim me Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore, të identifikojnë nevojat e grave rurale për pjesëmarrjen e tyre në tregun e punës, si dhe të planifikojnë fonde për financimin e programeve të nxitjes së punësimit të tyre.

[Deri në shtator 2024 dhe në vijimësi](#)

4.1 Rekomandim:

Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive, të analizojë rezultatet e monitorimit të aktiviteteve të zhvilluara në përmbushje të objektivave të Strategjisë Kombëtare të Punësimit dhe të ndërmarrë aktivitete specifike që sjellin adresimin e problematikave të konstatuara nga rezultatet e monitorimit.

[Në vijimësi](#)

Grupi i auditimit

Ermira Vojka – Përgjegjëse e grupit të auditimit
Arminda Bushi – Audituese
Jorida Zhegu – Audituese

Kontrolli i Lartë i Shtetit



ANEKSE

Përgjigje e observacioneve

Për sa trajtuar në Projekt Raportin e Auditimit janë paraqitur observacione nga Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive me nr. 1178/3 Prot. datë 19.01.2024, administruar në Kontrollin e Lartë të Shtetit me nr. 262/30 Prot., datë 23.01.2024.

1. Pretendimet e subjektit:

Subjekti në lidhje me "Gjetje nga auditimi" 1, 2, 3, 4 dhe 5, faqet 36-37 të projekt-raportit, nuk ka kundërshtime, por nëpërmjet observacioneve, AKPA ka sqaruar mbi mënyrën e funksionimit të saj, të programeve të punësimit dhe procese pune, të cilat janë iniciuar gjatë fazës së kryerjes së këtij auditimi dhe aktualisht janë në proces.

Mbi gjetjen nr. 1, Shpjegimi:

Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive, mbështet integrimin në tregun e punës të personave që janë të angazhuar aktivisht në kërkimin e një pune. Zyrat e Punësimit regjistrojnë dhe trajtojnë me shërbime punësimi çdo punëkërkues që paraqitet në to. Punëkërkuesit e papunë të regjistruar, dakordësojnë përfshirjen në tregun e punës edhe nëpërmjet pjesëmarrjes në programet e nxitjes së punësimit.

Mbi gjetjen nr. 2, Shpjegimi:

Programet e Nxitjes së Punësimit për vitin 2020, filluan në tremujorin e katërt të vitit. Përfundimi i këtyre programeve, i përkon tremujorit të dytë dhe të tretë të vitit 2021. Prandaj, edhe gjurmimi post-nxitje, i cili duhet të realizohet 6 muaj pas përfundimit të këtyre programeve, përkon me tremujorin e dytë të vitit 2022. Faza e anketimit/gjurmimit, nisi në muajin mars 2022 dhe përfundoi në muajin korrik 2022. Databaza me rezultatet e gjurmimit, u dërgua në AKPA Qendrore për të vijuar me procesin e validimit, analizimit dhe përgatitjes së Raportit, i cili u finalizua brenda vitit 2022. Sipas procesit dhe afateve të sipërpërmendura, gjatë periudhës mars-korrik 2023, u realizua procesi i gjurmimit të pjesëmarrësve në PNP 2021-2022. Aktualisht, ka përfunduar validimi i të dhënave dhe jemi në procesin e hartimit të raportit.

Mbi gjetjen nr. 3, Shpjegimi:

Theksojmë edhe një herë që, Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive, mbështet integrimin në tregun e punës të personave që janë të angazhuar aktivisht në kërkimin e një pune dhe paraqiten për regjistrim në Zyrat tona të Punësimit.

Mbi gjetjen nr. 4, Shpjegimi:

Në mbështetje të Ligjit Nr. 57/2019 "Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë" dhe VKM-së nr. 597/2019 "Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike", nuk kanë detyrimin të paraqiten dhe të regjistrohen në Zyrën e Punës anëtarët në moshë aktive pune të aftë për punë, të familjeve që zotërojnë tokë bujqësore në pronësi/përdorim dhe banojnë në fshat. Megjithatë, në mbështetje të VKM-së nr. 822, datë 24.12.2019 "Për mekanizmin e bashkërendimit ndërinstitucional të punës për referimin për punësim të individëve dhe anëtarëve në moshë aktive pune të familjeve përfituese të NE", të Urdhrit të Përbashkët të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë dhe Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale Nr. 52, datë 26.01.2022 "Për miratimin e mekanizmit të referimit për punësimin dhe integrimin social të individëve në moshë aktive pune", në të gjithë rajonet u ngritën dhe funksionojnë

12 komisione rajonalë, të cilët vlerësojnë, referojnë për punësim dhe integrim social, anëtarët në moshë aktive pune. Këto komisione, përbëhen nga përfaqësues të Shërbimit Social Shtetëror, Drejtoritë Rajonale të Punësimit dhe Drejtoritë e Shërbimeve Sociale në Bashki. AKPA është angazhuar maksimalisht në trajtimin e të gjithë rasteve të përfituesve të Ndhmës Ekonomike dhe integrimin e tyre në tregun e punës.

Mbi gjetjen nr. 5, Shpjegimi:

AKPA disponon të dhëna për kursantët, të cilët kanë ndjekur kurset e formimit profesional, sipas njësive bashkiake ku ata banojnë. Edhe pse Qendrat e Formimit Profesional janë të lokalizuara në qytetet kryesore, në bazë të kërkesave apo nevojave specifike, në disa raste, ato kanë hapur kurse edhe në bashkitë më të vogla në bashkëpunim me Shkollat e Mesme Profesionale apo bizneset. Për rajonin verilindor, kurset e formimit profesional ofrohen nga Qendra e Formimit Profesional Lëvizëse, e cila ofron kurse në disa njësi vendore të këtij rajoni.

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Sa më sipër, lidhur me observacionet e subjektit, ato japin një pamje të gjerë dhe qartësojnë proceset e programeve të punësimit, grupi i auditimit i merr në konsideratë këto përpjekje që do të trajtohen në raportin e auditimit, por gjetjet dhe rekomandimet qëndrojnë të pandryshuara, pasi AKPA duhet të sigurohet që të gjitha iniciativat e nisura gjatë vitit 2023, të finalizohen dhe zhvillohen me sukses. Gjithashtu, grupi i auditimit bazuar në temën e auditimit, inkurajon AKPA-n të nxisë bashkëpunimin me institucionet e tjera qendrore dhe vendore me qëllim integrimin në tregun e punës të grave në zonat rurale.

2. Pretendimet e subjektit:

- Lidhur me gjetjen e auditimit "Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive, nuk ka ngritur pika shërbimi në Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore të cilat nuk kanë zyra vendore punësimi, me qëllim trajtimin e çështjeve të punësimit, sikundër është përcaktuar në Strategjinë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive", sqarimi është si vijon: Me qëllim arritjen e kohezionit territorial të shërbimeve të punësimit, është rishikuar dhe miratuar struktura e Drejtorive Rajonale të Punësimit, ku për herë të parë janë ngritur 2 zyra vendore punësimi lëvizëse në Tiranë dhe Durrës, ku do të angazhohen specialistë në njësi dhe zona të pambuluara. Gjithashtu, në shumë njësi administrative ku nuk ka zyra pune, ka specialistë të dedikuar. Përmendim: Rrogozhinë, Shijakun, Poliçanin, Vaun e Dejës, Patosin etj. Por, një risi shumë e madhe, është edhe digjitalizimi i shërbimeve të punësimit; AKPA ka siguruar qasjen online të të gjitha shërbimeve kryesore të punësimit, nëpërmjet portalit e- Albania. Në këtë kuadër, është realizuar përmirësimi i faqes zyrtare të AKPA-s, duke zgjeruar gamën e informacionit dhe të funksionaliteteve të tij dhe së fundmi, të portalit të punësimit puna.gov.al. Shërbimet online shërbejnë për një qasje më të lehtë të shërbimeve dhe në shumë raste në shmangien e nevojës për paraqitjen fizike në sportel.

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Informacioni i paraqitur nga AKPA, tregon se nga ana e saj, janë bërë përpjekje dhe janë gjetur alternativa për të ofruar shërbimin e punësimit në zonat ku nuk ka zyra vendore punësimi. Grupi i auditimit i merr në konsideratë këto përpjekje, por gjetja dhe rekomandimi qëndrojnë, pasi AKPA duhet të sigurohet që të gjitha zonat e pambuluara, të marrin shërbimet e punësimit në mënyrën më efektive me zyra lëvizëse punësimi apo me angazhimin e specialistëve.

3. Pretendimet e subjektit:

Për sa trajtuar në Projekt-Raportin e Auditimit, janë paraqitur observacione nga Bashkia Elbasan 54/4, datë 30.01.2024, administruar në Kontrollin e Lartë të Shtetit me nr. 262/31 Prot., datë 05.01.2024. Bashkia Elbasan ka plotësuar me informacion të dhënat mbi njësitë administrative në total dhe investimet në kopshte, çerdhe dhe infrastrukturë për vitin 2023.

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Referuar të dhënave të paraqitura nga Bashkia Elbasan me observacionin nr. 54/4, datë 30.01.2024, vënë në dispozicion të grupit të auditimit më datë 06.02.2024, kjo bashki ka plotësuar informacionin dhe këto të dhëna janë trajtuar në raportin përfundimtar.

